

PROCES VERBAL - Tipi i kontratës – PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: Ndertim rrjet Ujesjellesi, qyteti Mamurras, Faza II
Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj; 30 (tridhjetë) muaj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45000000-7 - Punë ndërtimi, 45210000-2 - Punime ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT: 932,310,470 (nenteqind e tridhjetë e dy milion e treqind e dhjetë mijë e katerqind e shtatedhjetë) lek pa tvsh, vene ne dispozicion nga Buxheti i Shtetit.
Vlera ne euro: 10,055,117.2 (dhjetë milion e pesedhjetë e pese mijë e njeqind e shtatembedhjetë pike dy) euro

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga **Buxheti i Shtetit**.

Autoriteti kontraktor në kriteret e përgjedhjes së fituesit ka përgjedhur si më poshtë:

A) Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit ☐	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanise ☐	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social ☐	pikët 10
Periodha e garancisë së objektit ☐	pikët 5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomike më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkimore dhe grafike) kohën e propozuar (**jo më shumë se 30 muaj**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]

I Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 3 muaj) [2 pike].

II Grafiku i punimeve te Kontratës. [13 Pike]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{\min k2a} \times P_{\max k2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k2a}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k2a}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2a} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Staf / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushen specifike [13 pikë]

***Shënim:** Vlerësimi i këtij nenkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve me poshte:

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kriterëve të vecantë të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperience në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e vecanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperience në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kriterëve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të leshuar nga punëdhënësi të mëparshëm ose përfituesit.

b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

***Shënim:** Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologji të ndërrimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyresin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbejnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësive.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kriterëve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / eficientë / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciativë sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k5}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k5}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k5}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Argumentim:

Autoritetet Ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në barze çmimit ose kotos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, ne përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilesi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës procedurë prokurimi, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshihen:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë. projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij:

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit, Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve, ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë substancës së tyre thelbësore.

5, Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i i, çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të raste kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Njësia e Prokurimit hartoj kërkesën për Grafikun e punimeve dhe kohën e mobilizimit dhe ka kërkuar këto kriter 20 pikë, duke vlerësuar rëndësinë që ka ky element në përfundimin e plotë dhe realizimin suksesor të çdo veprë, pasi duke ndërthurur elementin cilësi, saktësi dhe precizion në kryerjen e punimeve por edhe angazhimin realisht të të gjithë stafit, inxhinierë, teknikë, specialistë, punëtorë të thjeshtë etj, mund të arrihet që punimet të kryhen edhe më shpejt se koha e planifikuar nga autoriteti kontraktor dhe njëherësh me cilësinë e duhur, duke i dhënë besimin këtij autoriteti për angazhimin serioz dhe të operatorit ekonomik pjesëmarrës cili në përfundim do të sjellë rezultatet e kërkuara dhe të pritura nga autoriteti.

Operatori Ekonomik mund të propozojë duke paragitur një grafik te detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori Ekonomik ofertues duhet të argumentoj në mënyrë përshkrimore kohën e propozuar të kryerjes së punimeve.

Po kështu një rëndësi e vecantë nga autoriteti kontraktor i jepet edhe elementit Staf/ Organizimi Kompanise, i cili vlerësohet deri në 15 pike, duke ditur që vetm një staf kualifikuar profesional inxhiniero - teknik dhe me pervoiën e duhur mund te sielle rezultatet e dëshiruara dhe të pritra nga autoriteti, kontraktor për përfundimin me sukses të objektit të prokurimit. Një operator ekonomik cili ka një staf te tillë mund të konkurrojë me cilesi pranë autoritetit kontraktor dhe te permbushe te githe detyrat e projekt preventivit të parashikuar nga autoriteti kontraktor. Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se do të angazhojë në kontratë një staf me përvojë eksperiencë te mjaftueshme per te realizuar me sukses objektin e prokurimit.

Disa nga nënkriteret janë formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia ne fushën specifike i cili provohet me dokumentacionin përkatës Gjithashtu operatori ekonomik duhet të paragesë edhe skemën e organizimit të stafit të propozuar per realizimin e kontrates, organigramen e propozuar te stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra- tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor etj.

Në lidhje me Propozimet per uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, autoriteti kontraktor ka kërkuar deri në 10 pikë, duke ditur rëndësinë që ka mjedisi aktualisht dhe fakti që ne me veprimet apo mosveprimet tona ndikojnë në mjedis dhe në komunitetin tonë të përbashkët pozitivisht/ negativisht

Duke patur parasysh se përvec realizimit të veprës duhet që të aplikohet nga operatorët realizues të punimeve edhe parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit. Duke ditur që nga punimet që do të kryhen gjatë ndërtimit të një vepre mund të krijohen mbetje inerte, detyrat kryesore që do të ketë parasysh operatori ekonomik janë ndër te tjera edhe kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes së mjedisit në territorin ku do të zhvillohet aktiviteti, mbajtja pastër e gjithë territorit ku kryhet veprimtaria, respektimi dhe zbatimi i te gjitha masave per të eliminuar ndikimin ne mjedis, flore dhe faune, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në popullsi, shëndetin human, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave per të eliminuar ndikimin ne klimë, ajër, ujë, tokë etj. Në veçanti duhet ti kushtoje rëndësi edhe faktorëve: Respektimi i procedurave, normave, standarteve dhe planifikimet e paragitura ne projekt gjate realizimit te tij si dhe të kontrollojnë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisorë.

Per të gjitha këto elementë operatori ekonomik pjesëmarrës bën një pasqyrë të qartë dhe te detajuar që në momentin kur ai konkuron në procedurën e prokurimit duke dhenë Propozime konkrete se si do te ndikojë në uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, dhe më pas autoriteti kontraktor ben vleresimin real me pikëzim të cdo operatori ekonomik ofertues.

Nenkriteret për operatoret ekonomike pjesëmarrës ne këtë rast dhe që do te vlerësohen në mënyrë të pikëzuar nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave i Autoritetit Kontraktor, do të ienë:

Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (migësore me miedisin të ricikluara/ eficente/materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Perdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike, Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si nje iniciativë sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar t'i zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM Nr. 285/2021 (i ndryshuar), kriteri i ofertës ekonomike më të favorshme bazohet në kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur, e cila nuk përmend afatin e përcaktuar, do të vlerësohet minimalisht për një periudhë 2 (dy) vjeçare. Çdo ofertues, i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh, për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet me formulën e paraqitur në nënkriteret e mësipërme.

Një rëndësi e vecantë i është dhënë edhe Periudhës së garancisë së objektit e cila tregon jetegjatësinë e objektit, faktin se sa me maksimale të jetë periudha aë perfshin garancina e vepres e deklaruar nga operatori ekonomik pjesëmarrës, aq me tepër autoriteti kontraktor bindet për angazhimin, seriozitetin dhe kapacitetin e këtij operatori ekonomik, me qëllimin final realizimin përfundimtar të vepres dhe marrjen në dorëzim të saj.

Argumentim i detajuar i peshës së pikëve për secilin kriter vlerësimi të ofertës ekonomike më të favorshme bazuar në kosto Autoriteti Kontraktor, në përcaktimin e sistemit të pikëzimit për vlerësimin e ofertave, ka mbajtur në konsideratë natyrën, kompleksitetin teknik, volumin e punimeve, rreziqet e zbatimit dhe rëndësinë e secilit element në realizimin me sukses të objektit të kontratës. Sistemi i pikëzimit është ndërtuar mbi një balancë ndërmjet elementit ekonomik dhe elementeve teknike të cilësore, duke respektuar parimet e përcaktuara në nenin 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe dispozitat e nenit 87 të Ligjit nr. 162/2020 për përdorimin e ofertës ekonomike më të favorshme dhe kërkesat e nenit 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar për argumentimin e kriterëve.

Pesha e secilit kriter është përcaktuar sipas ndikimit real që ai ka në realizimin teknik, ekonomik dhe funksional të objektit.

1. Kriteri “Çmimi” – 50 pikë

Argumentimi i peshës së kriterit Kriteri i çmimit është vlerësuar me 50 pikë, duke qënë kriteri me peshën më të lartë në procesin e vlerësimit, pasi Autoriteti Kontraktor synon respektimin e parimit të efektivitetit dhe ekonomisë në përdorimin e fondeve publike.

Pesha prej 50 pikësh është vendosur duke respektuar kërkesën që, në rastet kur përdoren më shumë se një kritere vlerësimi, kriteri ekonomik duhet të ketë rëndësi të konsiderueshme dhe të mos mbizotërohet nga elementët subjektivë teknikë.

Megjithatë, për shkak të natyrës së objektit, çmimi nuk është vendosur si kriter i vetëm, pasi realizimi i punimeve kërkon jo vetëm një ofertë ekonomike konkurruese, por edhe: kapacitete teknike të mjaftueshme; staf të kualifikuar; pajisje dhe makineri specifike; organizim efikas të punimeve; garantim të cilësisë dhe funksionalitetit të objektit.

Në punimet komplekse infrastrukturore, një ofertë me çmimin më të ulët nuk garanton automatikisht ofertën më të mirë, pasi një çmim jo realist mund të ndikojë në cilësinë e punimeve, afatet dhe qëndrueshmërinë e objektit.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka ruajtur një peshë të barabartë midis komponentit ekonomik (50 pikë) dhe komponentit teknik (50 pikë).

2. Kriteri “Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit” – 20 pikë

Argumentimi i peshës së kriterit: Ky kriter është vlerësuar me 20 pikë, pasi në një kontratë ndërtimore me volum të konsiderueshëm punimesh, respektimi i afateve dhe organizimi i proceseve teknologjike janë faktorë thelbësorë për suksesin e zbatimit.

Objekti kërkon realizimin e një sërë procesesh të ndërlidhura si: mobilizimi i kantierit; organizimi i burimeve njerëzore; angazhimi i makinerive; realizimi i punimeve sipas fazave teknologjike; testimi dhe kolaudimi i sistemeve.

Një grafik pune i hartuar në mënyrë profesionale garanton: përdorim racional të makinerive; koordinim të ekipeve; shmangie të vonesave; kontroll të progresit të punimeve.

Pesha prej 20 pikësh është proporcionale me rëndësinë e këtij elementi, pasi vonesat në realizimin e punimeve infrastrukturore mund të sjellin pasoja teknike, ekonomike dhe sociale.

Ndarja e pikëve:

a) Koha e realizimit dhe mobilizimi – 15 pikë

Kjo pjesë vlerëson aftësinë e operatorit për të organizuar fillimin dhe realizimin e kontratës.

Koha e mobilizimit – 2 pikë

Është vlerësuar pasi mobilizimi i shpejtë ndikon në fillimin efektiv të punimeve, ngritjen e kantierit, sjelljen e makinerive dhe organizimin e stafit.

Grafiku i punimeve – 13 pikë

Është elementi kryesor i këtij kriteri, pasi tregon mënyrën konkrete se si operatori do të realizojë objektin brenda afatit kontraktor.

Kërkesa për analizën e makinerive dhe numrit të punonjësve për çdo proces është vendosur për të verifikuar që grafiku nuk është vetëm deklarativ, por teknikisht i realizueshëm.

b) Faktorë favorizues/pajisje inovative/metodologji – 5 pikë

Këto pikë synojnë të vlerësojnë operatorët që propozojnë metoda më efikase pune, përdorim teknologjish moderne dhe organizim që mund të reduktojë kohën e realizimit pa cenuar cilësinë.

3. Kriteri “Stafi / Organizimi i kompanisë” – 15 pikë

Argumentimi i peshës së kriterit

Ky kriter është vlerësuar me 15 pikë, pasi realizimi i objektit kërkon jo vetëm fuqi punëtore, por staf teknik me eksperiencë dhe aftësi menaxhuese.

Punimet infrastrukturore kërkojnë koordinim ndërmjet disiplinave të ndryshme teknike, si: ndërtimi; hidroteknika; mekanika; elektriciteti; topografia; menaxhimi i cilësisë.

Për këtë arsye, eksperiencia dhe formimi profesional i stafit ndikojnë drejtpërdrejt në: cilësinë e zbatimit; kontrollin teknik; menaxhimin e riskut; respektimin e projektit.

Ndarja e pikëve:

a) Formimi akademik dhe eksperiencia – 13 pikë

Kjo pjesë ka peshën kryesore sepse aftësia profesionale e stafit është një nga faktorët kryesorë të suksesit të kontratës.

Përmbushja minimale e kërkesave – 1 pikë

Vlerëson garantimin e kapacitetit minimal të kërkuar.

Kualifikime akademike mbi minimumin – 3 pikë

Nxit angazhimin e personelit me përgatitje më të lartë profesionale.

Eksperiencë pune mbi minimumin – 3 pikë

Vlerëson përvojën praktike dhe aftësinë për menaxhimin e situatave teknike.

Eksperiencë në kontrata të ngjashme – 6 pikë

Ka peshën më të madhe pasi eksperiencia specifike në objekte të ngjashme ul ndjeshëm riskun e dështimit teknik.

b) Organizimi i stafit – 2 pikë

Vlerësohet mënyra e strukturimit të ekipit, komunikimi ndërmjet niveleve të menaxhimit dhe sistemet e kontrollit të cilësisë.

Një organizim i qartë siguron: përgjegjësi të përcaktuara; reagim të shpejtë ndaj problematikave; kontroll më të mirë të punimeve.

4. Kriteri “Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social” – 10 pikë

Argumentimi i peshës së kriterit

Ky kriter është vlerësuar me 10 pikë, pasi punimet infrastrukturore kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedisin dhe komunitetin ku zhvillohen.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të rëndësishme jo vetëm realizimin fizik të objektit, por edhe mënyrën se si realizimi ndikon në: mjedisin; banorët; trafikun; përdorimin e burimeve natyrore.

Ndarja:

a) Masa mjedisore – 5 pikë

Vlerësohen: përdorimi i materialeve ekologjike; pajisjet me eficiencë më të lartë; reduktimi i pluhurit dhe ndotjes; menaxhimi i mbetjeve; masat parandaluese mjedisore.

b) Ndikimi social – 5 pikë

Vlerësohen: punësimi lokal; përfshirja e komunitetit; ndikimi pozitiv ekonomik në zonën e projektit.

5. Kriteri “Periudha e garancisë së objektit” – 5 pikë

Argumentimi i peshës së kriterit

Ky kriter është vlerësuar me 5 pikë, pasi garantimi pas përfundimit të punimeve është një element i rëndësishëm për mbrojtjen e interesit të Autoritetit Kontraktor.

Një periudhë më e gjatë garancie: tregon besueshmërinë e operatorit; garanton përgjegjësi për defektet; redukton kostot e mirëmbajtjes; siguron jetëgjatësi të objektit.

Ky kriter ka peshë më të ulët pasi garancia është një element pas përfundimit të punimeve dhe nuk ndikon në të njëjtën masë si çmimi, organizimi dhe kapacitetet teknike gjatë zbatimit.

Formula e vlerësimit relativ siguron trajtim proporcional dhe objektiv ndërmjet ofertave.

Përfundim i përgjithshëm

Ndarja e pikëve: 50 pikë për çmimin 50 pikë për komponentët teknikë, është një ndarje e balancuar dhe proporcionale me natyrën e objektit.

Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se për një objekt kompleks ndërtimor, zgjedhja e operatorit ekonomik nuk mund të bazohet vetëm në ofertën më të ulët financiare, por duhet të marrë në konsideratë edhe aftësinë reale për realizimin e punimeve me cilësi, siguri dhe brenda afateve.

Autoriteti Kontraktor ndalon mbështetjen në kapacitet e subjekteve të tjera si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

X

Jo

☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

- Kapaciteti ekonomik dhe financiar Kriteve të veçanta të kualifikimit, Pika 2.2.1, 2.2.2, 2.2.3.
- Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të Kriteve të veçanta të Kualifikimit;
- Licenca e kërkuara sipas pikës 2.3.2/a, 2.3.2 b), 2.3.2 c) , të kapacitetit Teknik të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 7 e DST-së.
- Staf i Teknik i kërkuar sipas pikës 2.3.3/a, 2.3.3/b, 2.3.3 c) 2.3.3/d , 2.3.3 g) , si dhe pika 2.3.4 të Kapacitetit Teknik të Kriteve të veçanta të Kualifikimit, Shtojca 7 e DST-se.

Argumentimi ligjor: Në mbështetje të Nenit 84, pikat 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 90, pikat 5 dhe 6 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Autoriteti kontraktor ka vlerësuar se kapacitetet teknike dhe profesionale që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e punimeve kryesore nuk mund të transferohen tërësisht tek subjekte të treta, pasi kjo do të cenonte qëllimin e verifikimit të aftësisë reale të operatorit ekonomik që paraqet ofertën.

Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera është lejuar vetëm në masën që këto subjekte të marrin përsipër realisht realizimin e pjesës përkatëse të punimeve dhe të disponojnë licencat, personelin, pajisjet dhe eksperiencën që lidhet me zërat konkretë të preventivit që do të ekzekutojnë. Për këtë arsye është kërkuar që secili subjekt mbështetës ose anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë të disponojë licencat përkatëse në raport me punimet që merr përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit dhe ndarjes së punimeve.

Ky kufizim mbështetet në faktin se:

- *Licencat e ndërtimit përbëjnë autorizime profesionale të lidhura me aftësinë konkrete të subjektit për të realizuar kategori të caktuara punimesh dhe nuk mund të përdoren formalisht nga një operator që nuk disponon kapacitetet minimale për ekzekutimin e kontratës.*
- *Drejtuesit teknikë, stafi inxhinierik dhe specialistët e kërkuar janë të lidhur drejtpërdrejt me realizimin e punimeve të objektit dhe me mbikëqyrjen teknike të tyre gjatë gjithë periudhës së zbatimit. - Pajisjet dhe materialet teknologjike të kërkuara në projekt kërkojnë njohuri të specializuara instalimi dhe përgjegjësi profesionale që nuk mund të garantohen nëse operatori ofertues nuk disponon vetë kapacitetet bazë teknike për realizimin e kontratës.*

Për rrjedhojë, kufizimi i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera është vendosur për të garantuar që operatorit ekonomik ofertues të zotërojë vetë kapacitetet kryesore dhe thelbësore për realizimin e kontratës, ndërsa mbështetja nga subjektet e tjera të shërbejë vetëm si kapacitet plotësues dhe jo si zëvendësim i plotë i aftësisë teknike dhe profesionale të operatorit ofertues.

Gjithashtu, në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit N.162 / 2020 Per Prokurimin Publik, të ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2 të VKM Nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve, Lezhe Sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe

miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentim për mosndarjen e objektit të prokurimit në lote

Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se objekti i prokurimit nuk duhet të ndahet në lote, pasi ndarja e tij do të cenonte unitetin teknik dhe funksional të veprës, koordinimin e proceseve të zbatimit, përgjegjësinë për cilësinë e punimeve dhe garantimin e funksionimit të plotë të objektit të ndërtimit.

Ky vlerësim është bërë duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, kompleksitetin teknik të ndërhyrjeve, ndërvlerësinë ndërmjet zërave të preventivit, kërkesat e projektit të zbatimit, mënyrën teknologjike të realizimit të punimeve dhe detyrimet ligjore që burojnë nga legjislacioni për prokurimin publik dhe ai për ndërtimin.

Objekti i prokurimit përbëhet nga një kompleks punimesh ndërtimore, hidroteknike dhe infrastrukturore, të cilat janë të lidhura ngushtë ndërmjet tyre dhe përbëjnë një proces të vetëm teknik për realizimin e një vepre funksionale.

Punimet e parashikuara nuk janë procese të pavarura, por janë pjesë të një cikli të integruar zbatimi, ku secila fazë varet nga realizimi korrekt i fazave paraardhëse dhe ndikon drejtpërdrejt në fazat pasardhëse.

Në mënyrë konkrete, punimet përfshijnë procese të tilla si: punime gërmimi dhe përgatitje të trasese; sistemim dhe përgatitje të bazamentit; furnizim dhe vendosje tubacionesh; montim rakorderish dhe elementesh lidhëse; realizim bashkimesh me saldim HDPE dhe elektrofuzion; ndërtim strukturash ndihmëse prej betoni; punime rikthimi dhe rehabilitimi të sipërfaqeve; testime me presion uji; inspektime teknike të rrjeteve; kolaudim dhe vënie në funksion të sistemit.

Këto procese përbëjnë një zinxhir teknologjik të pandashëm, ku cilësia e një procesi ndikon drejtpërdrejt në funksionimin e gjithë veprës.

Për shembull, realizimi i tubacioneve nuk mund të konsiderohet i ndarë nga testimi i tyre me presion, nga kontrolli i bashkimeve, nga punimet e mbulimit dhe rikthimit të terrenit. Një ndarje e këtyre proceseve në lote të ndryshme do të krijonte vështirësi në përcaktimin e përgjegjësiive teknike në rast defektesh, rrjedhjesh ose mosfunksionimi të sistemit.

Zërat e preventivit janë hartuar mbi bazën e një procesi të vetëm ndërtimor dhe nuk përfaqësojnë punime të izoluar.

Punimet e gërmimit lidhen me vendosjen e tubacioneve; vendosja e tubacioneve lidhet me saldimin dhe bashkimin e elementeve; bashkimet lidhen me testimet e presionit; testimet lidhen me pranimin teknik të punimeve dhe më pas me rikthimin e terrenit.

Nëse këto punime do të ndaheshin në lote të ndryshme, do të krijoheshin problematika si: mungesë koordinimi ndërmjet operatorëve ekonomikë; vonesa në kalimin nga një fazë pune në tjetrën; ndërhyrje të ndërsjella në kantier; vështirësi në menaxhimin e grafikut të punimeve; vështirësi në përcaktimin e përgjegjësisë për dëmtime ose defekte; rritje e kostove administrative dhe teknike për administrimin e kontratave.

Për më tepër, një kontratë e vetme garanton që një subjekt i vetëm mban përgjegjësinë për integritetin teknik të të gjithë sistemit, duke shmangur ndarjen artificiale të përgjegjësiive ndërmjet disa kontraktorëve.

Realizimi i objektit kërkon disponimin e një grupi të integruar makinerish dhe pajisjesh specifike, të cilat përdoren në disa faza të ndryshme të punimeve.

Pajisjet si: makineritë për saldim HDPE; aparatet elektrofuzive; pajisjet e testimit me presion; automjeti për inspektim me kamera; pajisjet topografike; makineritë e gërmimit dhe transportit; nuk lidhen me një pjesë të izoluar të punimeve, por shërbejnë për realizimin e të gjithë procesit teknik.

Ndarja në lote do të sillte përsëritje të panevojshme të pajisjeve, shtim të kostove dhe ulje të eficiencës ekonomike të procedurës.

Në bazë të nenit 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, procedurat e prokurimit duhet të zhvillohen duke respektuar parimet e: transparencës; trajtimit të barabartë; mosdiskriminimit; eficiencës dhe ekonomisë në përdorimin e fondeve publike; proporcionalitetit.

Ndarja në lote nuk është një qëllim në vetvete, por një instrument që përdoret kur ajo sjell përfitime reale në drejtim të rritjes së konkurrencës dhe eficiencës.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktor ka analizuar se ndarja në lote nuk do të sillte përfitim teknik apo ekonomik, por do të krijonte rrezik për: fragmentimin e përgjegjësisë teknike; uljen e kontrollit mbi cilësinë; vështirësi në koordinimin e punimeve; rritje të kostove të administrimit të kontratës.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, kërkesat dhe organizimi i procedurës duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me natyrën dhe objektin e kontratës. Për një objekt kompleks ndërtimor, kërkohet që operatori ekonomik të ketë kapacitetet e plotë teknike dhe profesionale për realizimin e të gjithë veprës.

Sipas nenit 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në këtë kuadër, mosndarja në lote është vlerësuar si zgjidhja më e përshtatshme për natyrën konkrete të kontratës.

Sipas parimeve të legjislacionit shqiptar për ndërtimin dhe zbatimin e punimeve ndërtimore, realizimi i një vepre duhet të garantojë: përpunueshmërinë me projektin e zbatimit; cilësinë e materialeve dhe punimeve; qëndrueshmërinë dhe sigurinë teknike; kontrollin dhe kolaudimin e objektit.

Një objekt ndërtimi duhet të trajtohet si një tërësi funksionale, ku elementet përbërëse duhet të jenë të koordinuara dhe të ndërveprojnë sipas projektit teknik.

Ndarja në lote e proceseve që kanë lidhje teknologjike do të krijonte rrezik për humbjen e kontrollit të integruar të cilësisë dhe për mosfunksionimin e elementeve të veprës si një sistem i vetëm.

Duke marrë në konsideratë: natyrën komplekse të punimeve; ndërvarësinë e proceseve teknologjike; lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet zërave të preventivit; nevojën për një menaxhim unik të kantierit; kërkesën për një përgjegjësi të vetme teknike për cilësinë dhe funksionalitetin e objektit; parimet e eficiencës dhe proporcionalitetit sipas Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”;

Autoriteti Kontraktor ka arsyetuar se mosndarja e objektit të prokurimit në lote është zgjidhja më e përshtatshme teknike, ekonomike dhe ligjore, pasi garanton realizimin e plotë, të koordinuar dhe cilësor të objektit, duke shmangur fragmentimin e përgjegjësisë dhe duke siguruar mbrojtjen e interesit publik.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të balanceve të tre viteve të fundit **2023, 2024, 2025** të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë sipas nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas balanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit **2023, 2024, 2025** lëshuar nga Administrata Tatimore, ku xhiro mesatare e këtyre tre viteve të jetë me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar **të vitit 2026** sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në

rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare; ...3.** Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, **paragrafi 1 dhe 2 germa “b”**, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton: “Çdo tatimpagues përgatit **deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme** në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, **duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël**, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni9 ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përfundimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat”; Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës

elektronike”. Ne keto kushte, vleresojme të kërkojme kete dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Njësia e prokurimit kerkoi edhe **pagesat e taksave vendore** bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga çdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit se në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme te realizuar me ente publike, duhet te paraqese Kontratën e Sipërmarrjes; formular vleresimi leshuar nga Investitori sipas Shtojces 9;situcion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve;Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet te paraqese vertetime te shoqeruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një

bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”*

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 te VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës. Përvojat e mëparshme janë element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e mëparshme në

projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

Referuar këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”(i ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM te dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të përllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1.

Duke qenë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 2.3.2 dhe ne fund janë propozuar dhe vendosur nga specialisti i fushës, pjesë e njësisë së prokurimit, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik si dhe njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “**Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik**”

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë kriter, duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 *“Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- | | |
|--|----------------------|
| • Kategoria NP- 1 Punime germimi në toke | Klasifikimi B |
| • Kategoria NP- 4 Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai..... | Klasifikimi B |
| • Kategoria NP- 7 Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje | Klasifikimi G |
| • Kategoria NP- 12 Punime të inxhinierisë së mjedisit | Klasifikimi A |
| • Kategoria NS- 1 Punime për prishjen e ndërtimeve | Klasifikimi A |
| • Kategoria NS- 8 Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura | Klasifikimi A |
| • Kategoria NS-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni | Klasifikimi B |
| • Kategoria N.S- 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV | Klasifikimi B |
| • Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike | Klasifikimi B |

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.*

Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar, përcaktohet:

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Kategoritë e licensës së kërkuar janë

përcaktuar duke u bazuar në zërat konkretë të preventivit dhe në natyrën e punimeve që do të realizohen.

Duke u bazuar në preventivin e objektit “**Ndërtim Rrjet Ujësjellësi i Qytetit Mamurras, Bashkia Kurbin (Vazhdimi)**”, Nga shqyrtimi i preventivit të objektit “**Ndërtim Rrjet Ujësjellësi i Qytetit Mamurras, Bashkia Kurbin (Vazhdimi)**”, rezulton se realizimi i kontratës përfshin punime gjurmimi, ndërtim dhe rehabilitim rrugësh, vendosje tubacionesh të ujësjellësit, punime betonarmeje, punime topografike, instalime elektrike dhe telekomunikacioni të sistemit SCADA, si dhe punime të lidhura me infrastrukturën e ujësjellësit. Për këtë arsye kërkohen kategoritë e mëposhtme të licencës, kërkesat për kategoritë e licencës profesionale argumentohen si më poshtë:

Kategoria NP-1 “Punime gjurmimi në tokë” – Klasifikimi B

Kjo kategori është e domosdoshme pasi objekti përfshin volume të konsiderueshme gjurmimesh për hapjen e traseve të rrjetit ujësjellës. Në preventiv parashikohen: Gjurmim dheu me ekskavator në kanale deri 2 m gjerësi – **73,848 m³**; Gjurmim dheu me ekskavator me shkarkim në tokë – **33,848 m³**; Gjurmim me krahë në seksione të detyruara – **2,055 m³**; Transport materialesh dheu – **75,916.8 m³**.

Pika e licenses kërkohet pasi preventivi parashikon volume të konsiderueshme gjurmimesh për hapjen e traseve të rrjetit të ujësjellësit, konkretisht: Gjurmim dheu me ekskavator në kanale me gjerësi deri në 2 m, në sasinë mbi 107,000 m³; Gjurmime me krahë në seksione të detyruara; Transport dhe sistemin materialesh të gjermuara; Përforcim të gjurmimeve dhe mbushje të kanaleve.

Volumet e mësipërme përfaqësojnë punime kryesore të objektit dhe kërkojnë operator ekonomik të pajisur me licencën NP-1.

Kategoria NP-4 “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai...” – Klasifikimi B

Kjo kategori kërkohet pasi realizimi i rrjetit ujësjellës shoqërohet me rikthimin e gjendjes ekzistuese të rrugëve pas vendosjes së tubacioneve. Preventivi përfshin: Shtresë stabilizanti t=15 cm – **25,860 m²**; Mbushje me çakëll në trupin e rrugës – **64,797 m³**; Mbushje me material të gjermuar – **35,903 m³**; Shtresë çakëlli t=20 cm – **25,860 m²**; Skarifikim asfalti ekzistues – **25,860 m²**; Binder 6 cm – **25,860 m²**; Asfaltobeton 4 cm – **25,860 m²**; Prerje asfalti – **82,430 ml**.

Kjo kategori lidhet drejtpërdrejt me rikthimin në gjendjen ekzistuese të rrugëve pas vendosjes së rrjetit të ujësjellësit. Preventivi përfshin: Shtresa stabilizanti; Mbushje me çakëll dhe material gurorë; Shtresa binderi; Shtresa asfaltobetoni; Skarifikim asfalti ekzistues; Prerje asfalti; Trotuare dhe sinjalistikë horizontale. Vlera e këtyre punimeve është e konsiderueshme dhe përbën një komponent të rëndësishëm të kontratës.

Këto punime përbëjnë rikonstrukcion të konsiderueshëm të shtresave rrugore, duke e bërë të domosdoshme kategorinë NP-4.

Kategoria NP-7 “Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje” – Klasifikimi G

Objekti i prokurimit ka në thelb ndërtimin e rrjetit shpërndarës të ujësjellësit dhe për këtë arsye kjo kategori përbën kategorinë kryesore të licencës.

Preventivi përfshin: Furnizim dhe vendosje të tubacioneve PE100-RC PN10 dhe PN16 me diametra nga Ø20 mm deri Ø250 mm, me gjatësi totale mbi **200 km rrjet shpërndarës**; Saraçineska, valvola, reduktorë presioni, hidrantë; Puseta kontrolli dhe shkarkimi; Matësa uji dhe pajisje të sistemit të furnizimit me ujë; Tubacione çeliku dhe pjesë speciale të rrjetit.

Kjo është kategoria kryesore e objektit, pasi kontrata konsiston në ndërtimin e rrjetit shpërndarës të ujësjellësit. Preventivi përfshin: Furnizim dhe vendosje tubacionesh PE100-RC me diametra nga Ø20 mm deri Ø250 mm; Tuba çeliku për ujësjellës; Saraçineska, valvula, reduktorë presioni dhe

aksesorë hidraulikë;Hidrante;Puseta kontrolli;Matësa elektromagnetikë;Matësa uji Multijet;Elementë të tjerë të rrjetit shpërndarës.

Për shkak të natyrës së veprës dhe vlerës së konsiderueshme të punimeve hidraulike, kërkohet licenca NP-7 me klasifikim G.

Kategoria NP-12 “Punime të inxhinierisë së mjedisit” – Klasifikimi A

Kjo kategori lidhet me punimet që ndikojnë në mjedis gjatë realizimit të rrjetit dhe rehabilitimin e zonave të prekura nga ndërhyrjet.

Preventivi përfshin:Transport dhe menaxhim të materialeve të gërmuara; Shkulje rrënjësh dhe sistemim bimësie; Punime rikuperimi të terrenit pas gërmimeve; Punime të lidhura me rehabilitimin e sipërfaqeve të prekura nga ndërtimi i rrjetit.

Kërkesa që Operatori Ekonomik të disponojë licencën profesionale për Kategorinë NP-12 “Punime të inxhinierisë së mjedisit” – Klasifikimi A është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve objekt kontrate, të cilat lidhen me ndërhyrje infrastrukturore që kanë ndikim në mjedis dhe kërkojnë zbatim të kontrolluar të masave për mbrojtjen e tij gjatë fazës së ndërtimit.

Punimet e parashikuara në projekt përfshijnë gërmime në terren, hapje kanalesh për instalimin e tubacioneve, transport dhe depozitim të materialeve të gërmuara, rikthim të sipërfaqeve të prekura, menaxhim të mbetjeve të ndërtimit, si dhe rehabilitim të zonave të ndërhyrjes, procese të cilat duhet të realizohen në përputhje me kërkesat teknike dhe mjedisore.

Kategoria NP-12 “Punime të inxhinierisë së mjedisit” lidhet me aftësinë profesionale të operatorit për të realizuar punime që kërkojnë menaxhim të kontrolluar të ndikimeve mjedisore, duke përfshirë:menaxhimin e materialeve të dala nga gërmimet dhe mbetjeve të ndërtimit, duke shmangur ndotjen e tokës dhe zonave përreth; zbatimin e masave për kontrollin e pluhurit, zhurmave dhe ndikimeve të tjera gjatë punimeve; rehabilitimin dhe rikthimin e zonave të prekura nga ndërhyrjet ndërtimore; mbrojtjen e burimeve natyrore dhe elementëve ekzistues të mjedisit gjatë zhvillimit të punimeve; zbatimin e praktikave të punës që garantojnë minimizimin e ndikimit mjedisor të aktivitetit ndërtimor.

Klasifikimi A është i përshtatshëm duke marrë në konsideratë përmasat dhe karakteristikat e objektit, ku punimet zhvillohen në zona të ndryshme, përfshijnë ndërhyrje në terren, përdorim të makinerive të rënda, lëvizje të volumeve të konsiderueshme të materialeve dhe kërkojnë zbatim të masave të menaxhimit mjedisor gjatë gjithë periudhës së punimeve.

Disponimi i kësaj kategorie licencimi garanton që Operatori Ekonomik:disponon kapacitetet profesionale dhe teknike për menaxhimin e aspekteve mjedisore të punimeve; është i aftë të zbatojë kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit; mund të realizojë punimet duke minimizuar ndikimet negative në territorin ku zhvillohet ndërhyrja; garanton që proceset e ndërtimit të shoqërohen me masa konkrete për mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisit.

Kategoria NS-1 “Punime për prishjen e ndërtimeve” – Klasifikimi A

Kjo kategori justifikohet nga zërat e preventivit që parashikojnë prishje të elementeve ekzistuese për hapjen e traseve të rrjetit.

Punimet përfshijnë:Prishje shtresa betoni – **615 m³**; Prishje mure betonarme – **15.9 m³**.

Gjatë zbatimit të projektit për realizimin e punimeve të rrjetit të ujësjellësit, parashikohen procese që kërkojnë heqjen, çmontimin ose prishjen e kontrolluar të elementëve ekzistues ndërtimorë, si shtresa rrugore, trotuare, struktura të vogla betoni, elementë mbrojtës dhe ndërtime ndihmëse që pengojnë realizimin e punimeve.

Kategoria NS-1 “Punime për prishjen e ndërtimeve” është e nevojshme për realizimin profesional dhe të sigurt të proceseve si:Prishja e shtresave ekzistuese të asfaltit, betonit apo elementëve të

tjerë të infrastrukturës rrugore, për hapjen e traseve ku do të vendosen tubacionet; Heqja dhe çmontimi i elementëve ekzistues që pengojnë realizimin e punimeve të reja; Prishja e kontrolluar e strukturave të vogla ndërtimore dhe elementëve shoqërues, sipas nevojave të projektit; Grumbullimi, largimi dhe menaxhimi i materialeve të dala nga prishjet, në përputhje me kërkesat teknike dhe mjedisore; Rikthimi i sipërfaqeve të prekura pas përfundimit të ndërhyrjeve, duke garantuar funksionalitetin fillestar të zonave të punimeve.

Klasifikimi A argumentohet nga natyra dhe përmasat e ndërhyrjeve të parashikuara, ku punimet zhvillohen në zona të ndryshme dhe kërkojnë përdorimin e mjeteve mekanike, organizim të kontrolluar të punimeve dhe zbatim të masave të sigurisë gjatë proceseve të prishjes.

Kategoria NS-8 “Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri” – Klasifikimi A

Kjo kategori lidhet me realizimin e strukturave prej betoni dhe elementëve metalikë të nevojshëm për objektin.

Preventivi përmban: Struktura monolite betoni C16/20; Struktura monolite betoni C20/25; Struktura monolite betoni C25/30; Soleta betonarme; Hekur betoni; Konstruksione metalike të thjeshta.

Gjatë zbatimit të projektit parashikohen punime që lidhen me realizimin e strukturave prej betoni të armuar, elementëve prefabrikate dhe veprave shoqëruese, të cilat kërkojnë njohuri profesionale, staf të kualifikuar dhe kapacitete teknike të përshtatshme për përpunimin, montimin dhe kontrollin e cilësisë së këtyre elementëve.

Kategoria NS-8 “Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura” është e nevojshme për realizimin e proceseve si: Furnizimi, montimi dhe vendosja e elementëve parafabrikate prej betoni të armuar, sipas kërkesave të projektit dhe specifikimeve teknike; Realizimi i pusetave, dhomave teknike, bazamenteve dhe strukturave mbështetëse prej betoni të armuar për instalimin dhe funksionimin e elementëve të rrjetit të ujësjellësit; Ndërtimi i strukturave mbrojtëse dhe elementëve konstruktivë shoqërues, të nevojshëm gjatë zbatimit të linjave të furnizimit me ujë; Montimi dhe përshtatja e elementëve betonarme në terren, duke garantuar qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e tyre; Kontrolli i cilësisë së punimeve betonarme, në përputhje me kërkesat konstruktive dhe standardet teknike të zbatimit.

Kategoria NS-13 “Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni” – Klasifikimi B

Kjo kategori lidhet me komponentët e sistemit SCADA dhe transmetimit të të dhënave, të cilët funksionojnë nëpërmjet rrjeteve radio dhe telekomunikacionit.

Preventivi SCADA përfshin: Data Logger me kartë SIM; Module radio 868 MHz; Përsëritës sinjali radio; Stacione transmetimi radio; Regjistrim dhe konfigurim në sistemin SCADA; Transmetim dhe monitorim në distancë i të dhënave.

Në kuadër të realizimit të objektit, preventivi përfshin punime dhe furnizime që lidhen me **sistemin** e telekomunikacionit dhe transmetimit të sinjaleve, veçanërisht për funksionimin e sistemit të monitorimit dhe kontrollit të rrjetit, ku përfshihet Sistemi SCADA, si një nga komponentët kryesorë të menaxhimit dhe mbikëqyrjes së instalimeve hidraulike.

Kategoria NS-13 “Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni” është e nevojshme për realizimin e proceseve si: Instalimi i linjave dhe infrastrukturës së komunikimit për transmetimin e të dhënave nga pajisjet matëse dhe kontrolluese drejt sistemit qendror të monitorimit; Shtrimi, montimi dhe lidhja e kabllave të komunikimit dhe elementëve përkatës të telekomunikacionit, sipas konfigurimit të projektit; Integrimi i pajisjeve të telemetrisë dhe komunikimit me sistemin SCADA, për transmetimin në kohë reale të parametrave të funksionimit të rrjetit; Montimi dhe konfigurimi i elementëve ndihmës të komunikimit, të nevojshëm për funksionimin e sigurt të impianteve dhe

pajisjeve të kontrollit; Realizimi i ndërhyrjeve në infrastrukturën ekzistuese të komunikimit, gjatë zhvillimit të punimeve në terren.

Kategoria NS-14 “Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV” – Klasifikimi B

Kjo kategori kërkohet për instalimin dhe vënien në funksion të pajisjeve elektronike dhe elektrike të sistemit SCADA.

Punimet përfshijnë: Programimin e matësve elektromagnetikë; Programimin e manometrave elektronikë; Furnizimin dhe instalimin e stacioneve të transmetimit; Panele diellore dhe sisteme furnizimi me energji; Pajisje elektronike monitorimi dhe telemetrie.

Kërkesa që Operatori Ekonomik të disponojë licencën profesionale për Kategorinë NS-14 “Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV” – Klasifikimi B është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë instalimin e pajisjeve elektrike, sistemeve të kontrollit, furnizimit me energji dhe komponentëve elektronikë të nevojshëm për funksionimin e infrastrukturës së ujësjellësit.

Në kuadër të realizimit të objektit, preventivi përfshin pajisje dhe sisteme që kërkojnë furnizim elektrik, lidhje, komandim dhe integrim elektronik, si: Sistem SCADA për monitorimin dhe kontrollin e parametrave të rrjetit; Matës elektromagnetikë dhe pajisje matëse inteligjente; Pajisje automatizimi dhe kontrolli të impianteve të ujësjellësit; Elementë elektrikë dhe elektronikë të nevojshëm për funksionimin e sistemeve të instaluar.

Kategoria NS-14 “Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV” është e nevojshme për realizimin e proceseve si: Instalimi i impianteve elektrike të brendshme dhe lidhjeve të furnizimit me energji të pajisjeve teknike, sipas kërkesave të projektit; Montimi dhe lidhja e paneleve elektrike, kuadrove të komandimit dhe elementëve mbrojtës elektrikë për pajisjet e instaluar; Realizimi i lidhjeve elektrike ndërmjet pajisjeve të matjes, kontrollit dhe sistemeve të automatizimit; Instalimi i kabllimeve të sinjalit, komandimit dhe komunikimit brenda ambienteve teknike; Testimi dhe verifikimi i funksionimit të impianteve elektrike dhe elektronike pas instalimit. Kjo kategori licencimi është e domosdoshme për garantimin e: instalimit korrekt dhe të sigurt të pajisjeve elektrike dhe elektronike; lidhjes së sistemeve të matjes dhe monitorimit me burimet e energjisë dhe kontrollit; funksionimit të qëndrueshëm të sistemit SCADA dhe pajisjeve të automatizimit; respektimit të standardeve teknike për instalimet elektrike dhe mbrojtjen nga rreziqet elektrike.

Disponimi i kategorisë NS-14 – Klasifikimi B garanton që Operatori Ekonomik: disponon staf teknik të kualifikuar për realizimin e punimeve elektrike dhe elektronike; ka kapacitetet profesionale për instalimin dhe integrimin e pajisjeve të kontrollit; mund të realizojë testimin dhe vënien në funksion të sistemeve elektrike të objektit; siguron realizimin e punimeve në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe kërkesat e sigurisë.

Kategoria NS-18 “Punime topogjeodezike” – Klasifikimi B

Kjo kategori është e nevojshme për shkak të shtrirjes së konsiderueshme të rrjetit ujësjellës, identifikimit të traseve, koordinimit të nyjeve, pusetave dhe elementëve të rrjetit.

Punimet përfshijnë: Piketime të traseve të tubacioneve; Kontroll gjeodezik të kuotave dhe pjerrësive; Azhornim dhe rilevim të rrjetit të realizuar; Koordinim të pozicioneve të pusetave, valvolave, hidrantëve dhe pajisjeve SCADA përgjatë gjithë rrjetit. Punimet lidhen drejtpërdrejt me vendosjen e mbi 200 km tubacioneve të rrjetit ujësjellës.

Kërkesa që Operatori Ekonomik të disponojë licencën profesionale për Kategorinë NS-18 “Punime topogjeodezike” – Klasifikimi B është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës, kompleksitetit dhe shtrirjes së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat

përfshijnë ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit, instalimin e tubacioneve, realizimin e veprave shoqëruese dhe rikthimin e infrastrukturës ekzistuese.

Punimet objekt kontrate kërkojnë matje të sakta topografike, përcaktim të koordinatave, kuotave dhe pozicionimit të elementëve të projektit në terren, si dhe verifikim të vazhdueshëm gjatë fazave të zbatimit, për të garantuar që ndërtimi të realizohet në përputhje me projektin e miratuar.

Kategoria NS-18 “Punime topogjeodezike” është e nevojshme për realizimin e proceseve si: Rilevimi topografik i zonave të ndërhyrjes përpara fillimit të punimeve, për verifikimin e kushteve ekzistuese të terrenit; Pikëtimi dhe trasimi i aksit të linjave të ujësjellësit, sipas projektit dhe koordinatave të përcaktuara; Përcaktimi i kuotave të gërmimit dhe vendosjes së tubacioneve, duke garantuar pjerrësitë dhe nivelet e kërkuara teknike; Kontrolli topografik gjatë zbatimit të punimeve, për verifikimin e pozicionit horizontal dhe vertikal të tubacioneve, pusetave dhe strukturave shoqëruese; Matjet për përgatitjen e dokumentacionit pas përfundimit të punimeve, duke paraqitur gjendjen reale të veprës së realizuar.

Klasifikimi B argumentohet nga shtrirja dhe rëndësia e punimeve topogjeodezike që kërkojnë gjatë zbatimit, pasi objekti përfshin linja infrastrukturore me shtrirje të konsiderueshme, ndërhyrje në terrene të ndryshme dhe nevojë për kontroll të vazhdueshëm të parametrave gjeometrikë të veprës.

Punimet topogjeodezike janë veçanërisht të rëndësishme për: shmangien e devijimeve nga projekti gjatë instalimit të tubacioneve; garantimin e thellësisë dhe kuotave të sakta të vendosjes së linjave; koordinimin me infrastrukturën ekzistuese nëntokësore dhe mbitokësore; sigurimin e cilësisë dhe pranimit teknik të punimeve të realizuara.

b) Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomike:

- Çertifikate ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Çertifikate ISO 14001-2015/ 14001-2026 “Për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit” ose ekuivalente, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Çertifikate ISO 45001-2018/45001-2023 “Për Sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurimit në Punë” ose ekuivalente, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Çertifikate ISO 39001-2012 “Për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor” ose ekuivalente, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Çertifikate EN-ISO 3834-2:2021 “Sisteme të menaxhimit të cilësisë në saldim” ose ekuivalente, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Çertifikate ISO 1452-1:2009 “Sistemi i tubacioneve plastike për furnizimin me ujë) ose ekuivalente, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj (përveçse gjuhes angleze), ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontrates së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”¹ në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: aftësinë teknike dhe*

profesionale;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në bazë të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme. Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar çertifikatat e mësipërme për të vërtetuar se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës, por edhe sepse ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin e besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Në lidhje me objektin e prokurimit “**Ndërtim Rrjet Ujësjellësi i Qytetit Mamurras, Bashkia Kurbin (Vazhdimi)**”, kërkesa për çertifikatat ISO/EN argumentohet teknikisht në funksion të natyrës së punimeve, kompleksitetit të projektit dhe zërave konkretë të preventivit, si më poshtë:

1. Çertifikata ISO 9001:2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente

Kjo çertifikatë kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik disponon procedura të standardizuara për kontrollin e cilësisë gjatë gjithë ciklit të realizimit të punimeve.

Argumentimi mbështetet në faktin se objekti përfshin: Punime gërmimi mbi **109,000 m³**; Punime mbushjeje dhe rikonstruksioni rrugor mbi **25,860 m²**; Furnizim dhe montim të tubacioneve PE100-RC PN10 dhe PN16 me diametra nga Ø20 mm deri Ø250 mm dhe gjatësi shumë të konsiderueshme; Montim të mijëra aksesorëve hidraulikë, saraçineskave, valvolave, reduktorëve të presionit dhe matësve të ujit; Implementimin e sistemit SCADA dhe pajisjeve elektronike të monitorimit.

Për shkak të volumit dhe shumëllojshmërisë së proceseve të punës, ISO 9001 garanton kontroll të dokumentuar të cilësisë dhe përputhshmërisë së punimeve me projektin dhe specifikimet teknike. Kërkesa për çertifikatën ISO 9001:2015 argumentohet nga fakti se objekti përfshin një numër të konsiderueshëm procesesh ndërtimore dhe instalimesh teknologjike, të cilat kërkojnë kontroll të vazhdueshëm të cilësisë gjatë zbatimit.

Konkretisht lidhet me zërat: Shtresë stabilizanti t=15 cm – 25,860 m²; Mbushje me çakëll në trupin e rrugës – 64,797 m³; Binder 6 cm – 25,860 m²; Asfaltobeton 4 cm – 25,860 m²; F.V. tubacione PE100-RC PN10 dhe PN16 me diametra nga Ø20 mm deri Ø250 mm; F.V. saraçineska, valvola, reduktorë presioni, hidrantë; F.V. matësa uji DN ½”, DN ¾” dhe matësa elektromagnetikë; Instalimi dhe konfigurimi i sistemit SCADA.

Për shkak të numrit të madh të materialeve, pajisjeve dhe proceseve të punës, ISO 9001 garanton kontrollin e cilësisë së materialeve, montimit, testimeve dhe dokumentimit teknik.

2. Certifikata ISO 14001:2015 “Sistemi i Menaxhimit Mjedisor” ose ekuivalente

Kjo certifikatë lidhet drejtpërdrejt me ndikimin mjedisor që krijohet gjatë realizimit të punimeve. Preventivi përfshin: Gërmime masive në terren; Transport të materialeve dhe dherave në sasi të konsiderueshme; Prishje të strukturave ekzistuese prej betoni dhe betonarmeje; Punime shpyllëzimi dhe sistemimi të sipërfaqeve; Rikthim të shtresave rrugore dhe rehabilitim të zonave të prekura.

Për këtë arsye kërkohet që operatori ekonomik të disponojë një sistem të certifikuar për identifikimin, kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore gjatë zbatimit të kontratës

Kjo certifikatë lidhet me zërat që krijojnë ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis gjatë realizimit të kontratës.

Konkretisht: Gërmim dheu me ekskavator – 73,848 m³; Gërmim dheu me ekskavator me shkarkim në tokë – 33,848 m³; Gërmim me krahë – 2,055 m³; Transport materialesh dheu – 75,916.8 m³; Prishje shtresa betoni – 615 m³; Prishje mure betonarme – 15.9 m³; Shkulje rrënjësh dhe sistemim sipërfaqesh; Rikthim i shtresave rrugore pas vendosjes së rrjetit.

ISO 14001 siguron menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit, kontrollin e pluhurave, zhurmave dhe rehabilitimin e zonave të prekura nga punimet.

3. Certifikata ISO 45001:2018/2023 “Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë” ose ekuivalente

Kjo certifikatë argumentohet nga niveli i lartë i riskut që paraqesin punimet e objektit.

Punimet përfshijnë: Gërmime të thella në kanale; Punime me ekskavatorë, kamionë dhe makineri të rënda; Prishje strukturash betoni dhe betonarmeje; Montim tubacionesh me diametra të mëdhenj; Punime saldimi dhe montimi të elementeve metalike; Punime elektrike dhe elektronike të sistemit SCADA.

Për rrjedhojë, ISO 45001 garanton ekzistencën e procedurave të menaxhimit të rrezikut, mbrojtjes së punonjësve dhe parandalimit të aksidenteve gjatë realizimit të kontratës.

Lidhet me zërat: Gërmime në kanale për rrjetin ujësjellës; Perforcim gërmimi; Prishje shtresa betoni dhe betonarmeje; Montim tubacionesh me diametra deri Ø250 mm; Vendosje e saraçineskave, valvolave dhe aksesoreve; Punime me matësa elektromagnetikë dhe sistem SCADA; Punime me konstruksione metalike.

Përmasat e projektit dhe përdorimi i makinerive të rënda kërkojnë zbatimin e procedurave të certifikuara për sigurinë e punonjësve.

4. Certifikata ISO 39001:2012 “Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor” ose ekuivalente

Kjo certifikatë lidhet me faktin se punimet zhvillohen kryesisht në akse rrugore dhe zona të banuara ku do të kryhen ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese.

Preventivi përfshin: Hapje të traseve përgjatë rrugëve ekzistuese; Transport të vazhdueshëm të materialeve dhe dherave; Rikonstruksion të shtresave rrugore; Prerje asfalti dhe rehabilitim të rrugëve; Vendosje të sinjalistikës rrugore horizontale.

Prandaj kërkohet që operatori ekonomik të ketë procedura të certifikuara për menaxhimin e sigurisë së qarkullimit gjatë zhvillimit të punimeve.

5. Certifikata EN ISO 3834-2:2021 “Kërkesa të cilësisë për saldimin e materialeve metalike” ose ekuivalente

Kjo certifikatë justifikohet nga zërat e preventivit që përfshijnë elementë metalikë dhe punime saldimi.

Në preventiv parashikohen: Tubacione çeliku të hidroizoluara për rrjetin ujësjellës; Ventila çeliku me fllanxha; Konstruksiione metalike të thjeshta; Elementë metalikë ndihmës dhe aksesorë të rrjetit.

Për shkak se cilësia e saldimeve ndikon drejtpërdrejt në sigurinë dhe funksionalitetin e rrjetit, kërkohet EN ISO 3834-2 për të garantuar kontrollin e proceseve të saldimit.

6. Certifikata ISO 1452-1:2009 “Sisteme tubacionesh plastike për furnizimin me ujë” ose ekuivalente

Kjo certifikatë është drejtpërdrejt e lidhur me komponentin kryesor të kontratës, që është ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit me tubacione plastike PE100-RC.

Preventivi përfshin furnizimin dhe montimin e: Tubacioneve PE100-RC PN10 dhe PN16 me diametra nga Ø20 mm deri Ø250 mm; Manikotave elektrofuzive; Reduksioneve PE; Tee-ve PE; Adaptoreve PE; Rakorderive dhe aksesorëve të sistemit.

Duke qenë se pjesa më e madhe e rrjetit realizohet me sisteme tubacionesh plastike për furnizimin me ujë të pijshëm, ISO 1452-1 siguron që produktet dhe proceset e përdorura përmbushin standardet ndërkombëtare të performancës, rezistencës dhe sigurisë për rrjetet ujësjellëse.

Kjo certifikatë lidhet drejtpërdrejt me zërin kryesor të kontratës.

Preventivi përmban:

- ✓ Tub PE100-RC PN16 Ø250 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN16 Ø225 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN10 dhe PN16 Ø200 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN10 dhe PN16 Ø180 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN10 dhe PN16 Ø160 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN10 dhe PN16 Ø140 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN10 dhe PN16 Ø125 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN10 dhe PN16 Ø110 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN10 dhe PN16 Ø90 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN10 dhe PN16 Ø75 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN10 dhe PN16 Ø63 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN10 dhe PN16 Ø50 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN10 dhe PN16 Ø40 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN10 dhe PN16 Ø32 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN10 dhe PN16 Ø25 mm;
- ✓ Tub PE100-RC PN10 dhe PN16 Ø20 mm;
- ✓ Manikota elektrofuzive;
- ✓ Tee elektrofuzive;
- ✓ Reduksione PE;
- ✓ Adaptore PE;
- ✓ Rakorderi PE dhe aksesorë të tjerë të rrjetit.

Duke qenë se pjesa dërrmuese e fondit limit përbëhet nga furnizimi dhe montimi i tubacioneve PE100-RC dhe aksesorëve përkatës, ISO 1452-1 garanton që materialet dhe proceset e përdorura janë në përputhje me standardet ndërkombëtare për rrjetet e furnizimit me ujë të pijshëm.

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- ✓ Tuba Ujësjellësi PE100 RC
- ✓ Tub celiku $\phi > 200$
- ✓ Rakorderi gize

- ✓ Mates elektromagnetik
- ✓ Mates uji Multijet
- ✓ Sistem SCADA

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhena të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj (pervecese gjuhes angleze), ky dokument mund të paraqitet në gjuhën zyrtare shqipe ose angleze.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.
- Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë **certifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi** që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

d) Për matësat e ujit

- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë ose deklaratë nga prodhuesi / distributori i autorizuar që vërteton se standarti i prodhimit të matesave të ujit është sipas OIML R49 / ekuivalente me të, sipas rekomandimeve të Organizatës Internacionale të Metrologjisë Ligjore.
- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikaten e aprovimit sipas MID /ekuivalente me të, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9875 datë 14.02.2008 ndryshuar me Ligjin Nr. 10217 datë 21.01.2010, Ligjin Nr. 14/2013 dhe Ligjin Nr. 100/2015.

Argumentimi: Paraqitja e ketyre dokumenteve është vlerësuar pasi në objekt kemi të bëjmë me materiale (artikuj) që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.** Ky objekt, një ndër elementet më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve tubacione të ujësjellësit, matësa etj, që do të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe atë të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.

Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesën për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit, autorizimit të distributorit të autorizuar nga prodhuesi ose marrëveshjes së bashkëpunimit, si dhe katalogëve teknikë për materialet dhe pajisjet kryesore të sistemit të furnizimit me ujë.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së artikujve të sipercituar. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të Prodhuesit, Autoriteti ka mundësi të kontaktoje me Prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë. Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Vendosja e kriterit për **paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit** është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që Autoriteti të ketë një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave. Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike. Gjithashtu, bazuar në preventivin e punimeve, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ato duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, **me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga Autoriteti nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit**, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: **“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i**

plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Argumentimi i këtij kriteri duhet të mbështetet mbi faktin që artikujt e kërkuar përbëjnë komponentët kryesorë të objektit të prokurimit dhe përfaqësojnë një pjesë shumë të rëndësishme të vlerës së kontratës, ndaj Autoriteti Kontraktor duhet të garantojë origjinën, cilësinë, përputhshmërinë teknike dhe disponueshmërinë e tyre gjatë gjithë periudhës së realizimit të punimeve.

Kërkesa që operatorët ekonomikë të paraqesin autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për artikujt e mëposhtëm është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e objektit dhe me zërat kryesorë të preventivit, të cilët përbëjnë pjesën më të madhe të vlerës së investimit dhe janë elementë kritikë për funksionimin afatgjatë të sistemit të ujësjellësit.

1. Tuba Ujësjellësi PE100-RC

Në preventiv janë parashikuar sasi shumë të konsiderueshme tubacionesh PE100-RC PN10 dhe PN16, me diametra nga DN20 mm deri në DN250 mm, të shoqëruara me rakorderi, manikota elektrofuzive, adaptorë, tee, reduksione dhe pjesë të tjera speciale.

Materiali PE100-RC përfaqëson një teknologji të avancuar për rrjetet e ujësjellësit, me rezistencë të lartë ndaj plasaritjeve dhe dëmtimeve gjatë instalimit, duke garantuar jetëgjatësi dhe siguri të rrjetit.

Për këtë arsye, autorizimi nga prodhuesi garanton: origjinën dhe cilësinë e tubacioneve; përputhshmërinë me standardet për furnizimin me ujë; disponueshmërinë e aksesorëve të së njëjtës markë dhe sistem; mbështetjen teknike dhe garancinë e produktit gjatë zbatimit të kontratës.

2. Tub çeliku $\phi > 200$ mm

Preventivi parashikon furnizim dhe vendosje të tubave të çelikut të paraizoluar në fabrikë me diametër mbi 200 mm për segmentet kryesore të rrjetit ujësjellës.

Këto elemente janë pjesë strategjike e rrjetit dhe kërkojnë: certifikim të origjinës; karakteristika të garantuara mekanike dhe antikorrozive; përputhshmëri me pjesët lidhëse dhe armaturat.

Prandaj autorizimi i prodhuesit është i nevojshëm për të siguruar furnizim nga burime të autorizuar dhe produkte sipas specifikimeve teknike të projektit.

3. Rakorderi Gize

Në preventiv janë parashikuar saracineska gize, valvola moskthimi, pjesë speciale gize, hidrante dhe armatura të tjera që realizojnë funksionimin dhe kontrollin e rrjetit.

Këto pajisje: punojnë nën presion; ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë hidraulike të sistemit; duhet të jenë të kompatibilizuara me tubacionet dhe aksesorët e projektit.

Autorizimi i prodhuesit garanton origjinalitetin dhe përputhshmërinë teknike të produkteve të furnizuara.

4. Matës Elektromagnetik

Preventivi përfshin furnizimin dhe instalimin e matësve elektromagnetikë DN80-DN200, të aftë për matjen e prurjes, shpejtësisë, volumit dhe presionit, si dhe integrimin e tyre në sistemin e monitorimit.

Këto pajisje janë elementë elektronikë të specializuar dhe me vlerë të konsiderueshme financiare, ndaj autorizimi nga prodhuesi siguron: origjinën e pajisjeve; garancinë dhe suportin teknik; furnizimin me software, konfigurime dhe pjesë rezervë; integrimin korrekt me sistemin SCADA të projektit.

5. Matës Uji Multijet

Në preventiv janë parashikuar mbi 5,700 matës uji Multijet DN ½” dhe DN ¾”, të cilët do të instalohen në lidhjet individuale të abonentëve.

Duke qenë se këta matës përfaqësojnë komponentin kryesor të matjes së konsumit të ujit, autorizimi nga prodhuesi garanton: saktësinë metrologjike; cilësinë e prodhimit; disponueshmërinë e pjesëve rezervë; mbështetjen teknike dhe garancinë e produkteve.

6. Sistemi SCADA

Preventivi i veçantë i SCADA-s përfshin: programimin e matësve elektromagnetikë; konfigurimin e pajisjeve në sistem; Data Logger; module radio 868 MHz; përsëritës sinjali; stacione transmetimi; panele diellore dhe pajisje komunikimi.

Sistemi SCADA përbën platformën qendrore të monitorimit dhe kontrollit të rrjetit ujësjellës. Për shkak të kompleksitetit teknologjik dhe nevojës për integrim të plotë ndërmjet pajisjeve hardware dhe software, autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar është i domosdoshëm për të garantuar: licencimin dhe origjinën e sistemit; konfigurimin sipas kërkesave të projektit; mbështetjen teknike gjatë implementimit; mirëmbajtjen dhe përditësimet pas instalimit.

*Kërkesa për certifikimin sipas **OIML R49** ose ekuivalent argumentohet nga fakti se preventivi parashikon furnizimin e **5,754 matësve të ujit Multijet**, të cilët do të përdoren për matjen ligjore të konsumit të ujit për abonentët.*

Standardi OIML R49 garanton: saktësinë metrologjike; klasën e performancës së matjes; besueshmërinë e matësve në kushtet e përdorimit afatgjatë; përputhshmërinë me kërkesat ndërkombëtare për matësit e ujit.

*Ndërsa certifikimi **MID (Measuring Instruments Directive)** ose ekuivalent garanton që matësit janë të aprovuar për përdorim në transaksione tregtare dhe matje ligjore, në përputhje me legjislacionin shqiptar për metrologjinë dhe instrumentet matëse.*

Për rrjedhojë, duke qenë se matësit e ujit përbëjnë bazën e sistemit të faturimit dhe administrimit të konsumit për mijëra abonentë, kërkesa për OIML R49 dhe MID konsiderohet proporcionale, e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe e domosdoshme për garantimin e funksionimit korrekt të investimit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë punësuar minimalisht **80 (tetedhjete)** punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mesiperme në Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

- Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:
- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.
 - Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

Argumentim: Në mbështetje të nenit 77, pika 1 dhe pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter kualifikimi disponimin e një numri mesatar prej jo më pak se **80 (tetedhjetë)** punonjësish për periudhën e tre muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës së prokurimit.

Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

Në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter kualifikues disponimin e një numri mesatar prej jo më pak se 80 punonjësish për periudhën e 3 muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Ky kriter është vendosur duke u bazuar në natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e punimeve, si dhe në normativat e fuqisë punëtore të përcaktuara në Manualin të Ndërtimit, i cili përbën bazën e hartimit të preventivit dhe analizave teknike të objektit.

Objekti përfshin realizimin e një rrjeti të ri ujësjellësi me vlerë të konsiderueshme, ku parashikohen volume të mëdha punimesh civile, hidraulike, elektromekanike dhe teknologjike, të cilat duhet të kryhen paralelisht në disa fronte pune.

Objekti parashikon realizimin paralel të punimeve të gërmimit, montimit të rrjetit ujësjellës, rikonstruksionit të shtresave rrugore, punimeve të betonit, instalimeve teknologjike dhe sistemit SCADA, të cilat sipas manualit kërkojnë ekipe të specializuara dhe funksionim të njëkohshëm të disa fronteve pune.

Kërkesa që Operatori Ekonomik të disponojë minimalisht **80 (tetedhjetë) punonjës të punësuar për 3 (tre) muajt e fundit**, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, është vendosur duke u bazuar në **natyrën, volumin, kompleksitetin dhe shtrirjen e punimeve objekt kontrate**, si dhe në nevojën për të garantuar realizimin e tyre brenda afatit të përcaktuar kontraktual.

Nga analiza e preventivit të punimeve rezulton se objekti përfshin një numër të konsiderueshëm zërash pune të karakterit **hidroteknik, ndërtimor, mekanik, elektrik, topografik dhe punime infrastrukturore**, të cilat kërkojnë angazhim paralel të disa skuadrave të punës në kantier. Punimet përfshijnë ndër të tjera: punime gërmimi, hapje kanalesh dhe përgatitje traseje për linja ujësjellësi; vendosje dhe montim tubacionesh PE100 RC dhe tubacionesh çeliku me diametra të mëdhenj; montim rakorderish, elementësh hidraulikë dhe pajisjesh matëse; realizim të punimeve të betonit, armimit, rikonstruksioneve dhe rikthimit të sipërfaqeve të dëmtuara; punime elektrike, automatizimi dhe integrimi të sistemit SCADA; testime hidraulike, prova presioni, dezinfektim dhe vënie në funksion të rrjetit; punime topografike, kontroll gjeometrik dhe monitorim të vazhdueshëm të zbatimit; punime të lidhjeve me rrjetet ekzistuese dhe ndërhyrje në zona aktive të infrastrukturës.

*Për shkak të natyrës së punimeve, realizimi i kontratës nuk mund të kryhet nga një numër i kufizuar punonjësish, pasi kërkohet që disa procese pune të zhvillohen **njëkohësisht në segmente të ndryshme të objektit**, me qëllim respektimin e grafikut të punimeve dhe shmangien e vonesave.*

Numri minimal prej 80 punonjësish është përcaktuar duke marrë në konsideratë nevojën për krijimin e disa grupeve pune, ku përfshihen: staf teknik drejtues dhe mbikëqyrës; inxhinierë të profileve përkatëse; teknikë ndërtimi dhe topografë; hidraulikë dhe specialistë të montimit të tubacioneve; saldatorë dhe specialistë për punimet metalike; punonjës për testime dhe kolaudime; operatorë të makinerive të rënda; punëtorë ndërtimi, betonues, karpentierë, hekurkthyes dhe punonjës për punime rrugore; personel mbështetës për sigurinë në punë, kontrollin e cilësisë dhe organizimin e kantierit.

Gjithashtu, duke qenë se punimet përfshijnë përdorimin intensiv të makinerive të rënda (eskavatorë, automjete transporti, mjete ngritëse dhe pajisje të tjera të specializuara), kërkohet disponimi i personelit të kualifikuar për operimin e tyre, ndërkohë që ekipet e punës duhet të jenë të shpërndara sipas fronteve të ndryshme të punimeve.

*Kërkesa për një numër minimal prej 80 punonjësish nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garanton që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të kenë **kapacitetin real organizativ dhe teknik** për realizimin e një kontrate me volum të konsiderueshëm punimesh infrastrukturore. Kjo kërkesë është proporcionale me objektin e prokurimit, pasi lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e operatorit ekonomik për të mobilizuar burimet njerëzore të nevojshme për përfundimin e punimeve sipas standardeve teknike, kërkesave të projektit dhe afateve kontraktuale.*

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë** të cilet të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

• Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)
• Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
• Inxhinier Gjeoteknik	1 (një)
• Inxhinier Gjeodet / Topograf / Markshajder	1 (një)
• Inxhinier Elektrik	1 (një)
• Inxhinier Elektronik	1 (një)

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Stafi i kërkuar në pikën 2.3.3 pika b, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin tjetër inxhinierik** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi Profili Infrastruktura e transportit 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)

Për stafin e mësipërm inxhinierik Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune, CV dhe të figurojë në Listepagesa për të paktën 3 muajt e Fundit.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

d) Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), **Drejtnuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Shënim: Ky kriter konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

d) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si më poshtë:

- 2 (dy) Teknik Ndërtimi
- 1 (nje) Teknik Topograf
- 5 (pese) hidraulike
- 2 (dy) Specialist për montim tubash
- 2 (dy) Specialist për testimin e tubave nën presion
- 2 (dy) mekanik / automekanik
- 2 (dy) murator
- 2 (dy) montator
- 2 (dy) saldator
- 2 (dy) betonues
- 2 (dy) karpentier
- 1 (nje) elektrikist
- 1 (nje) hidroizolues
- 2 (dy) hekurkthyes
- 2 (dy) punëtorë për punime në rrugë dhe asfaltim
- 2 (dy) specialist për ndërtim
- 5 (pese) shofere për drejtim mjetesh të pajisur me leje drejtimi me kategorinë “C” dhe/ose “CE” dhe/ose “D” dhe/ose “DE” lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për specialistët e mësipërm (*me përjashtim të punonjësve shoferë*) të paraqiten kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

e) Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të paktën:

- 5 (pese) manovrator Eskavatoristë
- 4 (kater) manovrator Automakinistë
- 1 (nje) manovrator Buldozeristë

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontrate pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor; si dhe të figurojnë në listepagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë emer/mbiemer, profil i punës, numri dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerisë së dëshmisë së aftësisë profesionale.

Në rastin kur punonjësit Automakinist, Ekskavatoristë ose Buldozerist janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin

vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.**” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe /ose c) **fuqinë punëtore të operatorit ekonomik** të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Gjithashtu, bazuar në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore për licencimin profesional në fushën e ndërtimit, zbatimi i punimeve të ndërtimit duhet të realizohet nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e personelit teknik të kualifikuar sipas profileve përkatëse të inxhinierisë.

Në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar disponimin e stafit inxhinierik drejtues dhe mbështetës, pasi natyra e objektit **“Ndërtim Rrjet Ujësjiellësi i Qytetit Mamurras, Bashkia Kurbin (Vazhdimi)”** përfshin punime civile, hidraulike, gjeoteknike, topografike, elektrike, elektronike dhe teknologjike, të cilat kërkojnë mbikëqyrje profesionale të specializuar gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Objekti ka afat realizimi **30 muaj**, shtrihet në një territor të gjerë dhe përfshin një numër të konsiderueshëm zërash pune që duhet të zhvillohen paralelisht në disa fronte pune.

Inxhinier Hidroteknik – 1 (një) drejtues teknik

Kërkesa për Inxhinier Hidroteknik lidhet drejtpërdrejt me objektin kryesor të kontratës, që është ndërtimi i rrjetit të ujësjiellësit.

Preventivi përfshin: Furnizim dhe vendosje të tubacioneve PE100-RC PN10 dhe PN16 me diametra nga Ø20 mm deri Ø250 mm; Tubacione çeliku për rrjetin kryesor; Saraçineska, valvola, hidrantë dhe rakorderi; Matësa elektromagnetikë; Puseta kontrolli dhe shkarkimi; Testime dhe kolaudime hidraulike të rrjetit.

Inxhinieri hidroteknik është përgjegjës për: kontrollin e zbatimit të projektit hidraulik; kontrollin e kuotave dhe pjerrësive të tubacioneve; kontrollin e presioneve të punës; koordinimin e testeve hidraulike; kolaudimin teknik të rrjetit.

Për shkak se rrjeti ujësjiellës përbën komponentin kryesor të investimit, prania e tij është e domosdoshme.

Inxhinier Ndërtimi – 1 (një) drejtues teknik

Objekti përmban volume të konsiderueshme punimesh civile.

Preventivi përfshin: Gjurmime mbi 100,000 m³; Mbushje dhe ngjeshje; Prishje betoni dhe betonarmeje; Struktura betoni dhe betonarmeje; Ndërtim pusetash dhe veprash civile; Rikonstrukcion të shtresave rrugore.

Inxhinieri i ndërtimit është përgjegjës për:organizimin e kantierit; kontrollin e punimeve civile; kontrollin e cilësisë së betonit dhe materialeve; koordinimin e fronteve të punës; zbatimin e grafikut të punimeve.

Përmasat e objektit e bëjnë të domosdoshëm këtë profil.

Inxhinier Gjeoteknik – 1 (një) drejtues teknik

Preventivi përmban:Gërmime në kanale të thella; Punime mbushjeje; Stabilizim dhe ngjeshje të shtresave; Rikonstruksion të trupit të rrugës.

Inxhinieri gjeoteknik nevojitet për:kontrollin e karakteristikave të terrenit; kontrollin e stabilitetit të kanaleve; përcaktimin e metodologjisë së mbushjes dhe ngjeshjes; verifikimin e parametrave të shtresave mbajtëse.

Ky rol është veçanërisht i rëndësishëm për të shmangur deformimet dhe uljet e mëvonshme të rrjetit dhe shtresave rrugore.

Punimet për instalimin e tubacioneve të ujësjellësit zhvillohen në terrene me karakteristika të ndryshme gjeologjike dhe gjeoteknike, ku njohja dhe vlerësimi i kushteve të tokës është element thelbësor për garantimin e qëndrueshmërisë së veprës dhe sigurisë gjatë zbatimit.

Inxhinieri Gjeoteknik është i domosdoshëm për realizimin e detyrave si:Vlerësimi i karakteristikave gjeoteknike të terrenit ku do të zhvillohen punimet, përpara dhe gjatë procesit të zbatimit; Analiza e kushteve të tokës në zonat e gërmimit të kanaleve për vendosjen e tubacioneve, duke përcaktuar masat e nevojshme për stabilitetin e skarpave dhe sigurinë e punimeve; Kontrolli i përshtatshmërisë së materialeve të përdorura për mbushje dhe rikonstruksion, sipas kërkesave të projektit; Vlerësimi i proceseve të ngjeshjes së shtresave dhe mbushjeve, duke garantuar arritjen e parametrave të kërkuar teknikë; Dhënia e rekomandimeve teknike për trajtimin e zonave me kushte të dobëta të tokës, si zona me lagështi të lartë, materiale të paqëndrueshme ose rrezik deformimi; Mbikëqyrja e ndikimit të kushteve gjeoteknike në qëndrueshmërinë e tubacioneve, rrugëve dhe strukturave shoqëruese.

Nevoja për 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik si drejtues teknik lidhet me faktin se punimet kanë natyrë infrastrukturore dhe zhvillohen përgjatë traseve të gjata, ku kushtet e terrenit mund të ndryshojnë nga një segment në tjetrin. Prania e këtij specialisti garanton marrjen e vendimeve teknike në kohë dhe përshtatjen e metodologjisë së punimeve sipas kushteve reale të terrenit.

Disponimi i këtij pozicioni teknik siguron:rritjen e sigurisë gjatë punimeve të gërmimit dhe montimit të tubacioneve; parandalimin e problemeve të stabilitetit dhe deformimeve të mëvonshme të terrenit; kontrollin e cilësisë së mbushjeve dhe shtresave të rikonstruktura; zbatim të punimeve në përputhje me projektin, studimin gjeologjik/gjeoteknik dhe specifikimet teknike; menaxhim profesional të problematikave që lidhen me kushtet e tokës gjatë fazës së zbatimit.

Inxhinier Gjeodet / Topograf / Markshajder – 1 (një) drejtues teknik

Nga planimetria dhe projekti rezulton se rrjeti ka shtrirje të konsiderueshme territoriale me qindra nyje dhe pika lidhjeje.

Punimet kërkojnë:piketim të traseve; kontroll të kuotave të projektit; rievime të vazhdueshme; azhurnim të rrjetit të realizuar; hartimin e dokumentacionit.

Për shkak të gjatësisë së rrjetit dhe numrit të madh të elementeve hidraulike, ky profil konsiderohet i domosdoshëm.

Inxhinier Elektrik – 1 (një) drejtues teknik

Preventivi përfshin:Matësa elektromagnetikë; Data Logger; Panele diellore; Sisteme furnizimi me energji; Pajisje monitorimi dhe transmetimi.

Inxhinieri elektrik është përgjegjës për:instalimin e pajisjeve elektrike; furnizimin me energji të stacioneve; mbrojtjen elektrike të sistemit; testimet dhe vënien në punë.

Prania e tij lidhet drejtpërdrejt me komponentët elektrikë të sistemit.

Në preventiv janë parashikuar zëra që kërkojnë njohuri dhe mbikëqyrje profesionale elektrike, si: Furnizimi dhe instalimi i matësve elektromagnetikë, të cilët kërkojnë furnizim elektrik, lidhje me sistemet e kontrollit, konfigurim dhe verifikim të funksionimit; Furnizimi dhe instalimi i matësve të ujit Multijet, si pajisje matëse që kërkojnë integrim me sistemet e monitorimit dhe transmetimit të të dhënave, sipas konfigurimit të projektit; Furnizimi, instalimi dhe vënia në funksion e sistemit SCADA, i cili përfshin komponentë elektrikë, elektronikë dhe automatizimi për mbikëqyrjen dhe kontrollin në distancë të parametrave të rrjetit; Instalimi i paneleve të komandimit, kabllimeve elektrike dhe elementëve të furnizimit me energji për pajisjet e kontrollit dhe monitorimit; Lidhjet elektrike të pajisjeve dhe impianteve ndihmëse, të nevojshme për funksionimin e sistemit të ujësjellësit.

Inxhinieri Elektrik është i domosdoshëm për kryerjen e detyrave teknike si: Hartimi dhe ndjekja e skemave të furnizimit dhe lidhjeve elektrike të pajisjeve të instaluara; Mbikëqyrja e montimit të kabllimeve, paneleve elektrike dhe elementëve të mbrojtjes elektrike; Kontrolli i parametrave teknikë dhe sigurisë së instalimeve elektrike gjatë zbatimit; Koordinimi i integritetit të pajisjeve elektrike me sistemin SCADA dhe pajisjet e automatizimit; Kryerja e testeve funksionale dhe verifikimi i vënies në punë të pajisjeve elektrike dhe elektronike; Garantimi i zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe standardet e sigurisë elektrike.

Nevoja për 1 (një) Inxhinier Elektrik si drejtues teknik lidhet me faktin se punimet elektrike dhe automatizimi janë pjesë integrale e funksionimit të veprës dhe nuk mund të realizohen vetëm si punime ndihmëse. Sistemi SCADA, pajisjet matëse dhe komponentët e kontrollit kërkojnë koordinim profesional për të garantuar komunikimin, furnizimin me energji dhe funksionimin e plotë të sistemit.

Disponimi i këtij specialisti siguron: realizimin korrekt të instalimeve elektrike dhe automatike; shmangien e defekteve në lidhjet elektrike dhe sistemet e kontrollit; sigurinë e personelit dhe pajisjeve gjatë operimit; funksionimin e qëndrueshëm të sistemit të monitorimit dhe menaxhimit të rrjetit; kontrollin e cilësisë së punimeve elektrike gjatë gjithë fazës së zbatimit.

Inxhinier Elektronik – 1 (një) drejtues teknik

Preventivi përfshin: Sistem SCADA; Module radio; Përsëritës sinjali; Data Logger; Pajisje transmetimi dhe monitorimi në distancë.

Inxhinieri elektronik nevojitet për: konfigurimin e sistemit SCADA; integrimin e pajisjeve të telemetrisë; programimin e pajisjeve elektronike; monitorimin dhe testimin e komunikimit të sistemit.

Ky profil është i domosdoshëm për funksionimin korrekt të sistemit inteligjent të monitorimit të rrjetit.

Në kuadër të realizimit të objektit, preventivi përfshin pajisje dhe sisteme që kanë komponentë elektronikë dhe kërkojnë konfigurim, integrim dhe vënie në funksion nga personel i specializuar, konkretisht: Sistemi SCADA për monitorimin dhe kontrollin e rrjetit të ujësjellësit, i cili përfshin pajisje elektronike të grumbullimit, përpunimit dhe transmetimit të të dhënave; Matës elektromagnetikë, të cilët funksionojnë nëpërmjet moduleve elektronike për matjen, përpunimin dhe transmetimin e parametrave të rrjedhës; Matës uji Multijet, të cilët kërkojnë integrim me sistemet e leximit dhe monitorimit të të dhënave sipas kërkesave të projektit; Pajisje të telemetrisë, kontrollit dhe komunikimit, të nevojshme për transmetimin e informacionit nga pikat e matjes drejt sistemit qendror të monitorimit.

Inxhinieri Elektronik është i domosdoshëm për realizimin e detyrave teknike si: Mbikëqyrja e instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve elektronike të matjes dhe kontrollit; Integrimi i pajisjeve

elektronike me sistemin SCADA dhe platformat e monitorimit në distancë; Kontrolli i moduleve elektronike të komunikimit dhe transmetimit të të dhënave; Testimi funksional i pajisjeve elektronike pas instalimit dhe para vënies në operim; Diagnostikimi dhe eliminimi i problematikave teknike që lidhen me sensorët, transmetuesit dhe njësitë elektronike të kontrollit; Sigurimi i komunikimit korrekt ndërmjet pajisjeve matëse, sistemeve të kontrollit dhe qendrës së monitorimit.

Argumentimi për stafin tjetër inxhinierik

Inxhinier Ndërtimi – Profili Infrastrukturë dhe Transport – 1 (një)

Ky profil kërkohet për shkak të volumeve të konsiderueshme të punimeve rrugore.

Preventivi përfshin: Stabilizant 25,860 m²; Shtresa çakëlli 25,860 m²; Binder 25,860 m²; Asfaltobeton 25,860 m²; Prerje dhe rikonstruksion të shtresave rrugore.

Inxhinieri i Infrastrukturës dhe Transportit mbikëqyr: ndërtimin e shtresave rrugore; kontrollin e ngjeshjes; kontrollin e parametrave të asfaltit; organizimin e trafikut gjatë punimeve.

Për shkak të volumit të konsiderueshëm të rikonstruksionit rrugor, ky profil është i nevojshëm dhe proporcional me objektin.

Kërkesa për disponimin e 1 (një) Inxhinieri Ndërtimi – Profili Infrastrukturë dhe Transport është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë ndërhyrje në infrastrukturën rrugore, punime gjurmimi, rikonstruksion të shtresave rrugore, asfaltime dhe rikthim të gjendjes ekzistuese pas realizimit të punimeve të rrjetit të ujësjellësit.

Punimet objekt kontrate ndikojnë drejtpërdrejt në elementët e infrastrukturës së transportit, pasi realizimi i linjave të ujësjellësit kërkon hapje trashe në rrugë ekzistuese, prishje të shtresave rrugore, transport të materialeve, mbushje, ngjeshje dhe rikonstruksion të sipërfaqeve të prekura. Inxhinieri i Ndërtimit me profil Infrastrukturë dhe Transport është i domosdoshëm për realizimin e detyrave teknike si: Mbikëqyrja e punimeve të prishjes dhe rikonstruksionit të shtresave rrugore pas përfundimit të instalimit të tubacioneve; Kontrolli i zbatimit të shtresave të rrugës (nënshtresë, bazë, binder dhe asfalt) sipas projektit dhe specifikimeve teknike; Verifikimi i cilësisë së materialeve të përdorura për mbushje dhe stabilizim të trasheve të hapura në rrugë; Koordinimi i punimeve të asfaltimit dhe përdorimit të pajisjeve specifike, si asfaltoshtuese, rrulë vibrues, autobitumatrice dhe makineri për punime rrugore, të parashikuara në mjetet e kantierit; Kontrolli i ngjeshjes së shtresave rrugore, duke garantuar qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e rikonstruksionit; Menaxhimi i ndërveprimit të punimeve me trafikun rrugor dhe masat e sigurimit të qarkullimit gjatë punimeve.

Sipas preventivit, janë parashikuar zëra punimesh që lidhen drejtpërdrejt me infrastrukturën rrugore, si: punime gjurmimi dhe hapje kanalesh në zona të urbanizuara; largim dhe transport i materialeve të dala nga gjurmimet; mbushje dhe ngjeshje shtresash pas vendosjes së tubacioneve; rikthim i shtresave rrugore dhe asfaltim i segmenteve të prekura; përdorimi i makinerive të posaçme për punime rrugore, si grejder, rrul vibrues, asfaltoshtuese, autobitumatrice dhe mjete për prerje/frezim asfalti.

Nevoja për 1 (një) Inxhinier Ndërtimi – Infrastrukturë dhe Transport argumentohet nga fakti se punimet rrugore janë pjesë integrale e objektit dhe kërkojnë mbikëqyrje profesionale për të garantuar që ndërhyrjet në rrugë të mos ndikojnë në sigurinë dhe funksionalitetin e infrastrukturës ekzistuese.

Inxhinier Hidroteknik – 1 (një) staf mbështetës

Përveç drejtuesit teknik hidroteknik, kërkohet edhe një inxhinier hidroteknik shtesë për shkak të: gjatësisë së konsiderueshme të rrjetit; numrit të madh të nyjeve hidraulike; zhvillimit paralel të disa fronteve të punës; afatit 30-mujor të realizimit.

Ky inxhinier do të mbështesë: kontrollin e zbatimit të tubacioneve; kontrollin e lidhjeve dhe aksesoreve; testimet hidraulike; hartimin e dokumentacionit teknik të realizimit.

Për shkak të kompleksitetit të rrjetit ujësjellës dhe shtrirjes së projektit, disponimi i dy inxhinierëve hidroteknikë (1 drejtues teknik dhe 1 mbështetës) konsiderohet një kërkesë e arsyeshme dhe në përputhje me volumet e preventivit dhe organizimin e punimeve në disa fronte pune.

Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, si dhe legjislacionit në fuqi për ndërtimin, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të përcaktojë Drejtuesin Teknik të Punimeve në objekt, i cili duhet të jetë pjesë e licencës profesionale të shoqërisë, të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë periudhës së zbatimit të punimeve.

*Kjo kërkesë mbështetet në dispozitat e **Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”**, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, të cilat përcaktojnë se punimet e ndërtimit duhet të realizohen nën drejtimin dhe përgjegjësinë teknike të personave të licencuar, të cilët mbajnë përgjegjësi profesionale për zbatimin e projektit, cilësinë e punimeve, respektimin e kushteve teknike dhe garantimin e sigurisë së objektit.*

*Objekti “**Ndërtim Rrjet Ujësjellësi i Qytetit Mamurras, Bashkia Kurbini (Vazhdimi)**” përbën një investim kompleks infrastrukturë, me afat realizimi **30 muaj**, i cili përfshin: Punime gërmimi mbi 100,000 m³; Vendosi e rrjetit kryesor dhe sekondar të ujësjellësit; Ndërtimin e pusetave dhe nyjeve hidraulike; Montimin e matësve elektromagnetikë dhe matësve të ujit; Instalimin e sistemit SCADA; Rikonstrukcionin e shtresave rrugore dhe kthimin në gjendjen ekzistuese të infrastrukturës së prekur; Punime elektrike, elektronike dhe telekomunikacioni.*

Për shkak të volumit të madh të punimeve dhe zhvillimit paralel të disa fronteve pune, kërkohet një figurë përgjegjëse që të koordinojë, kontrollojë dhe mbikëqyrë zbatimin teknik të projektit në përputhje me dokumentacionin teknik dhe kushtet e kontratës.

Drejtuesi Teknik i Punimeve është figura që: organizon dhe drejton procesin e zbatimit në kantier; garanton zbatimin korrekt të projektit dhe specifikimeve teknike; kontrollon cilësinë e punimeve; koordinon stafin teknik dhe ekipet e punës; mban përgjegjësi për respektimin e kushteve të sigurisë në kantier; bashkëpunon me mbikëqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor; dokumenton dhe certifikon fazat e realizimit të punimeve.

Për këtë arsye, kërkohet që Drejtuesi Teknik të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së realizimit të objektit, pasi angazhimi i tij paralel në disa kontrata do të cenonte mundësinë për të ushtruar mbikëqyrje të plotë dhe efektive mbi punimet.

Kërkesa që Drejtuesi Teknik të jetë i përfshirë në licencën profesionale të operatorit ekonomik lidhet me faktin se licenca e shoqërisë mbështetet mbi kapacitetet profesionale të personelit teknik të deklaruar në të.

Në këtë mënyrë garantohej që: personi disponon kualifikimin profesional përkatës; ka lidhje të qëndrueshme pune me operatorin ekonomik; mban përgjegjësi profesionale në kuadër të licencës së subjektit; është pjesë e strukturës teknike reale të operatorit ekonomik dhe jo një burim i jashtëm i angazhuar vetëm për qëllime kualifikimi.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, kërkesa që secili operator të caktojë Drejtuesin Teknik për pjesën e punimeve që ka marrë përsipër është e nevojshme për të garantuar përgjegjësi të qarta teknike dhe administrative mbi secilin segment të kontratës.

Duke qenë se secili anëtar i bashkimit realizon pjesën e vet të preventivit sipas përqindjes së bashkëpunimit, është e nevojshme që edhe mbikëqyrja teknike të realizohet nga personel teknik i licencuar dhe përgjegjës për punimet që kryen secili operator.

Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesën për disponimin e personelit teknik dhe punonjësve të specializuar, pasi natyra e objektit **“Ndërtim Rrjet Ujësjellësi i Qytetit Mamurras, Bashkia Kurbin (Vazhdimi)”** përfshin volume të konsiderueshme punimesh civile, hidraulike, rrugore, mekanike, elektrike dhe teknologjike, të cilat sipas normativave të **Manualit Nr. 3 të Ndërtimit** kërkojnë personel të kualifikuar dhe të specializuar për realizimin e tyre.

Objekti ka afat realizimi **30 muaj** dhe kërkon zhvillimin paralel të disa fronteve pune për gërmimet, montimin e tubacioneve, ndërtimin e pusetave, rikonstruksionin e shtresave rrugore, instalimin e matësve, sistemit SCADA dhe testimet hidraulike.

Teknik Ndërtimi – 2 (dy)

Kërkesa lidhet me: gërmimet mbi 100,000 m³; mbushjet dhe ngjeshjet; ndërtimin e pusetave; punimet e betonit dhe betonarmesë; rikonstruksionin rrugor. Sipas Manualit të Ndërtimit, për organizimin e disa fronteve pune kërkohet personel teknik i ndërmjetëm që kontrollon zbatimin ditor të punimeve, sasitë, cilësinë dhe përputhshmërinë me projektin. Për shkak të shtrirjes së objektit dhe punimeve që zhvillohen paralelisht, kërkojnë minimumi **2 teknikë ndërtimi**.

Kërkojnë dy teknikë ndërtimi për të mbështetur inxhinierët përgjegjës në ndjekjen e përditshme të punimeve në kantier, kontrollin e volumeve të realizuara, organizimin e fronteve të punës dhe mbajtjen e dokumentacionit teknik. Duke qenë se punimet zhvillohen në disa procese paralelisht, prania e dy teknikëve garanton mbikëqyrje të vazhdueshme të aktiviteteve ndërtimore.

Teknik Topograf – 1 (një)

Preventivi dhe planimetria përfshijnë një rrjet të shtrirë në disa zona, me qindra nyje, puseta dhe pika lidhjeje. Tekniku topograf nevojitet për: piketimin e traseve; kontrollin e kuotave; rëlevimet e vazhdueshme; përgatitjen e dokumentacionit "as built". Ky funksion është i domosdoshëm gjatë gjithë zbatimit të projektit.

Punimet e shtrirjes së rrjetit të ujësjellësit kërkojnë piketim të vazhdueshëm, kontroll të kuotave dhe verifikim të pozicionimit të tubacioneve sipas projektit. Për këtë arsye kërkohet një teknik topograf që të asistojë proceset e matjeve dhe kontrollit topografik.

Hidraulikë – 5 (pesë)

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me: montimin e rrjetit PE100-RC; montimin e valvolave; montimin e saraçineskave; instalimin e hidrantëve; montimin e matësve.

Për shkak të gjatësisë së konsiderueshme të rrjetit dhe zhvillimit paralel të punimeve, nevojiten disa ekupe hidraulikësh për të përmbushur grafikun e punimeve.

Për shkak të volumeve të konsiderueshme të montimit të tubacioneve, rakorderive, valvolave dhe elementeve të tjera hidraulike, nevojiten hidraulikë të specializuar që të realizojnë instalimet sipas kërkesave teknike dhe standardeve të sektorit të ujësjellësit.

Specialist për montim tubash – 2 (dy)

Preventivi përmban vendosjen e tubacioneve PE100-RC me diametra nga Ø20 mm deri Ø250 mm, si dhe tubacione çeliku në segmentet kryesore.

Sipas normativave të Manualit të Ndërtimit, montimi i tubacioneve kërkon personel të specializuar për: pozicionimin e tubave; bashkimet elektrofuzive; lidhjet me pjesët speciale; kontrollin e pjerrësive dhe aksit të tubacionit.

Vendosja e tubacioneve PE100 RC dhe tubacioneve të çelikut kërkon specialistë me eksperiencë specifike në montimin dhe bashkimin e linjave. Këta specialistë sigurojnë realizimin korrekt të lidhjeve dhe funksionimin e rrjetit sipas parametrave të projektit.

Specialist për testimin e tubave nën presion – 2 (dy)

Pas vendosjes së rrjetit kryhen: prova hidraulike; prova presioni; testime rrjedhjeje; kolaudim teknik i segmenteve.

Duke qenë se projekti përfshin një rrjet shumë të gjerë ujësjellësi, testimet realizohen në segmente të ndryshme dhe kërkojnë personel të specializuar.

Mekanik / Automekanik – 2 (dy)

Objekti kërkon përdorimin e: ekskavatorëve; minieskavatorëve; kamionëve vetëshkarkues; autovinçave; makinerive të asfaltimit.

Për shkak të përdorimit të vazhdueshëm të makinerive gjatë 30 muajve, nevojiten mekanikë për mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre.

Objekti kërkon përdorimin intensiv të makinerive të rënda dhe mjeteve të transportit. Mekanikët janë të nevojshëm për mirëmbajtjen dhe ndërhyrjet teknike në makineri, me qëllim shmangien e ndërprerjeve gjatë zbatimit të punimeve.

Murator – 2 (dy)

Kërkesa lidhet me: ndërtimin e pusetave; muret mbajtëse; riparimet e elementëve ekzistues; sistemimet përfundimtare.

Në preventiv parashikohen punime për ndërtimin dhe rehabilitimin e pusetave, strukturave ndihmëse dhe rikthimin e elementeve ndërtimore të dëmtuara gjatë punimeve, çka justifikon nevojën për muratorë të kualifikuar.

Këto punime janë pjesë e preventivit civil të objektit.

Montator – 2 (dy)

Montatorët nevojiten për: vendosjen e pjesëve speciale; montimin e valvolave; montimin e matësve elektromagnetikë; montimin e elementeve mekanike të sistemit.

Montatorët janë të nevojshëm për montimin e pajisjeve mekanike, elementeve të rrjetit, aksesorëve hidraulikë dhe strukturave ndihmëse që parashikohen në projekt.

Saldator – 2 (dy)

Preventivi përfshin: tubacione çeliku; pjesë metalike; elemente të sistemit hidraulik.

Sipas analizave të Manualit të Ndërtimit dhe standardit EN ISO 3834, saldatorët janë të domosdoshëm për realizimin e lidhjeve metalike.

Punimet përfshijnë montimin dhe bashkimin e tubacioneve metalike dhe elementeve të tjera të çelikut. Për realizimin e këtyre proceseve sipas standardeve teknike kërkojnë saldatorë të certifikuar.

Betonues – 2 (dy)

Kërkesa lidhet me: beton C12/15; beton C16/20; beton C20/25; beton C25/30; ndërtimin e bazamenteve dhe pusetave.

Në preventiv janë parashikuar punime me beton për baza, puseta, blloqe ankorimi dhe struktura të tjera mbështetëse. Për këtë arsye kërkojnë betonues të specializuar.

Këta zëra kërkojnë betonues të specializuar sipas normativave të manualit.

Karpentier – 2 (dy)

Punimet e betonarmesë kërkojnë: kallëpime; formim strukturash; përgatitje elementësh betoni.

Punimet e betonit kërkojnë realizimin e kallëpeve dhe strukturave mbajtëse të përkohshme, të cilat kryhen nga karpentierë të kualifikuar.

Elektracist – 1 (një)

Preventivi përfshin: matës elektromagnetikë; Data Logger; stacione transmetimi; panele diellore; pajisje elektrike të sistemit SCADA. Për shkak të instalimit të pajisjeve elektrike, matësve elektromagnetikë dhe komponentëve të sistemit SCADA, kërkohet një elektrikist që të asistojë në realizimin e lidhjeve elektrike dhe testimeve përkatëse.

Hidroizolues – 1 (një)

Kërkesa lidhet me: pusetat; dhomat teknike; elementet e betonit që kërkojnë mbrojtje ndaj lagështisë dhe infiltrimeve. Në strukturat e betonit, pusetat dhe elementet që janë në kontakt të vazhdueshëm me ujin, kërkohen punime hidroizolimi për të garantuar jetëgjatësinë dhe funksionalitetin e veprës. Ky profesion është i nevojshëm për jetëgjatësinë e veprave civile.

Hekurkthyes – 2 (dy)

Preventivi përfshin punime betonarmeje dhe armatura çeliku. Sipas analizave të Manualit të Ndërtimit, për përgatitjen dhe montimin e armaturave kërkohen hekurkthyes të specializuar.

Punëtorë për punime në rrugë dhe asfaltim – 2 (dy)

Kërkesa argumentohet nga zërat: stabilizant 25,860 m²; shtresë çakëlli 25,860 m²; binder 25,860 m²; asfaltobeton 25,860 m²; rikthimi i gjendjes ekzistuese të rrugëve. Këta punëtorë janë pjesë e ekipeve të asfaltimit sipas normativave të manualit.

Specialist për ndërtim – 2 (dy)

Ky personel nevojitet për koordinimin e proceseve të ndryshme ndërtimore në terren dhe për mbështetjen e drejtuesve teknikë në disa fronte pune njëkohësisht.

Shoferë me kategori C/CE/D/DE – 7 (shtatë)

Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me makineritë dhe mjetet e kërkuara në preventiv dhe në kapacitetet teknike të kontratës: kamionë vetëshkarkues 5–10 ton; kamionë vetëshkarkues mbi 20 ton; kamioncina transporti; kamion me vinç; rimorkiator për transport mjetesh; mjete të transportit të materialeve.

Duke qenë se transporti i mbi 75,000 m³ materialesh dhe furnizimi i vazhdueshëm i kantierit realizohen paralelisht në disa fronte pune, disponimi i të paktën **7 shoferëve të kualifikuar** është proporcional me nevojat e kontratës dhe grafikun 30-mujor të punimeve.

Numri dhe profilet e mësipërme janë përcaktuar në funksion të: volumeve të konsiderueshme të preventivit; afatit të realizimit prej 30 muajsh; shtrirjes territoriale të rrjetit ujësjellës; nevojës për zhvillimin paralel të disa fronteve pune; normativave të fuqisë punëtore të Manualit Teknik të Ndërtimit;

Kërkesa për disponimin e këtij numri operatorësh të mjeteve të rënda është përcaktuar duke u bazuar në natyrën, volumin dhe mënyrën e realizimit të punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, si dhe në nevojën për garantimin e vijueshmërisë së punimeve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Nga analizimi i zërave të preventivit rezulton se realizimi i punimeve përfshin procese pune që kërkojnë përdorimin e vazhdueshëm të makinerive të rënda të ndërtimit, konkretisht: punime gjurmimi dhe hapje kanalesh; punime gjurmimi në terren të ndryshëm; ngarkim dhe transport të materialeve të dala nga gjurmimet; sistemim, nivelim dhe profilim të terrenit; përgatitje të bazamentit për shtresa ndërtimore; mbushje dhe ngjeshje pas përfundimit të instalimeve; punime infrastrukturore që kërkojnë operim të njëkohshëm të disa mjeteve mekanike.

Eskavatori është një nga makineritë kryesore të nevojshme për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv, veçanërisht për zërat që lidhen me: gjurmime me makineri; hapje traseje dhe kanalesh; largim të materialeve të gjurmara; punime për vendosjen e tubacioneve/infrastrukturës nëntokësore; ngarkim të materialeve inerte.

Për shkak të volumit të punimeve dhe nevojës për zhvillim paralel të disa fronteve të punës, kërkohet disponimi i disa eskavatorëve që mund të operojnë njëkohësisht. Numri prej 5 manovratorësh eskavatoristë lidhet drejtpërdrejt me nevojën për mbulimin e proceseve të ndryshme të punës dhe shmangien e ndërprerjeve gjatë realizimit të kontratës.

Sipas manualeve të përdorimit dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit, çdo makineri mekanike duhet të operohet nga personel i specializuar dhe i trajnuar, pasi efica dhe siguria e punimeve varen drejtpërdrejt nga aftësia profesionale e operatorit.

Punimet e parashikuara në preventiv kërkojnë transport të vazhdueshëm të: materialeve të gërmimit; materialeve mbushëse; materialeve inerte; elementëve dhe materialeve të furnizuara për realizimin e objektit.

Për këtë arsye, është e nevojshme që mjetet e transportit (kamionët vetëshkarkues, automjetet e transportit të materialeve dhe pajisjeve) të operohen nga drejtues të kualifikuar.

Numri prej 4 automakinistësh është përcaktuar duke marrë në konsideratë organizimin e punimeve në disa fronte, nevojën për transport paralel të materialeve dhe garantimin e vazhdimësisë së punës edhe gjatë ndryshimeve të turneve ose proceseve të ndryshme të zbatimit.

Buldozeri është makineri e domosdoshme për realizimin e proceseve të punës që lidhen me: sistemin dhe nivelimin e terrenit; shpërndarjen e materialeve të mbushjes; përgatitjen e sipërfaqeve të punës; krijimin e platformave të punimit; rregullimin e terrenit pas përfundimit të punimeve.

Kërkesa për një manovrator buldozerist është e lidhur me zërat e preventivit që kërkojnë punime mekanike të sistemit dhe përpunimit të terrenit, ku përdorimi i buldozerit është teknikisht i domosdoshëm.

f) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (ne rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimit të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- Minimumi 1 (një) punonjes të certifikuar me dëshmi trajnimit si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Punë”** të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin

g) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjeket duhet të jenë të pajisur me licencë profesionale të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti

kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin

Agumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si **përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash** dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikqyrjes.

Kjo kërkesë është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve të ndërtimit që do të realizohen sipas preventivit dhe projektit të zbatimit, ku parashikohen procese pune me shkallë të lartë ekspozimi ndaj rreziqeve profesionale, si: punime gërmimi dhe punime në kanale/trase; përdorim i makinerive të rënda të ndërtimit (eskavatorë, kamionë, buldozerë dhe mjete të tjera mekanike); punime me materiale ndërtimore dhe elementë të rëndë; punime në kantier me prezencë të një numri të konsiderueshëm punonjësish; ndërveprim ndërmjet mjeteve mekanike dhe fuqisë punëtore në të njëjtin front pune.

Nga analiza e zërave të preventivit rezulton se realizimi i objektit kërkon organizim të vazhdueshëm të kantierit dhe menaxhim të rreziqeve që lidhen me sigurinë e punonjësve, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale, sinjalistikën e kantierit, kontrollin e kushteve të punës dhe zbatimin e masave parandaluese.

Për këtë arsye, prania e një personi të dedikuar dhe të trajnuar për sigurinë dhe shëndetin në punë është e domosdoshme për:

- hartimin dhe zbatimin e masave të sigurisë në kantier;
- evidentimin dhe vlerësimin e rreziqeve gjatë proceseve të punës;
- kontrollin e përdorimit të mjeteve mbrojtëse individuale nga punonjësit;
- monitorimin e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik;
- trajnimin dhe informimin e punonjësve për rreziqet në vendin e punës;
- raportimin dhe marrjen e masave parandaluese në rastet e situatave të rrezikshme.

Argumentimi ligjor

Kërkesa mbështetet në detyrimet që burojnë nga legjislacioni shqiptar për sigurinë dhe shëndetin në punë, veçanërisht:

- Ligji nr. 10327, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i cili përcakton detyrimin e punëdhënësit për të garantuar mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve, përmes marrjes së masave parandaluese, organizimit të punës në kushte të sigurt dhe caktimit të personave përgjegjës për ndjekjen e çështjeve të sigurisë dhe shëndetit në punë.
- VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier", e cila përcakton kërkesat për organizimin e sigurisë në kantieret e ndërtimit, koordinimin e masave parandaluese dhe përgjegjësitë e subjekteve që zhvillojnë punime ndërtimore.
- Legjislacioni në fuqi për ndërtimin dhe zbatimin e punimeve ndërtimore, i cili kërkon që realizimi i punimeve të kryhet nga subjekte që disponojnë kapacitetet teknike, profesionale dhe organizative të nevojshme për garantimin e cilësisë dhe sigurisë gjatë zbatimit të objektit.

Lidhja me preventivin dhe organizimin e punimeve

Kërkesa për këtë specialist lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit që përfshijnë:

- punime me makineri të rënda dhe mjete mekanike;*
- punime gjurmimi dhe transporti;*
- punime infrastrukturore në ambiente kantieri;*
- punime që kërkojnë masa të veçanta sigurie për mbrojtjen e punonjësve dhe të personave të tretë.*

Rruli me vibrim është një makineri e domosdoshme për realizimin e proceseve të mëposhtme: Ngjeshjen e shtresave të mbushjes mbi tubacionet e instaluar, duke garantuar densitetin e kërkuar të materialeve dhe stabilitetin e zonës së ndërhyrjes; Ngjeshjen e shtresave granulare të bazamentit rrugor, si zhavorr, stabilizant dhe materiale të tjera të përcaktuara në projekt, përpara realizimit të shtresave asfaltike; Përgatitjen e sipërfaqeve të rikonstruktura pas punimeve të gërmimit, duke shmangur uljet dhe deformimet e mëvonshme të terrenit; Ngjeshjen e materialeve në zonat e rehabilituara të rrugëve dhe shesheve, ku kërkohet arritja e parametrave teknikë të specifikuar për shtresat mbajtëse.

Nevoja për **1 (një) rrul me vibrim** është e justifikuar pasi kjo makineri përdoret në fazat përkatëse të punimeve të mbushjes, sistemimit dhe rikonstruksionit të shtresave rrugore. Një njësi është e

mjaftueshme për të mbuluar nevojat e kantierit, duke u organizuar sipas grafikut të punimeve dhe progresit të realizimit të segmenteve të ndryshme.

Përdorimi i rrullit me vibrim siguron: arritjen e ngjeshjes së kontrolluar dhe uniforme të shtresave; rritjen e kapacitetit mbajtës dhe qëndrueshmërisë së bazamentit rrugor; parandalimin e deformimeve, fundosjeve dhe dëmtimeve të parakohshme të sipërfaqeve të rikthyera; përputhjen e punimeve me kërkesat teknike të projektit dhe standardet e zbatimit.

Rrul me vibrim (kompresor) për ngjeshje asfalti – 1 (një) copë

Rruli me vibrim për ngjeshje asfalti është një pajisje e domosdoshme për realizimin e fazës përfundimtare të punimeve rrugore, duke garantuar ngjeshjen e duhur të shtresave asfaltike dhe arritjen e parametrave teknikë të kërkuar në projekt.

Ky mjet nevojitet për kryerjen e proceseve si: Ngjeshja e shtresave asfaltike pas shtrimit me asfaltoshtruese, duke siguruar densitetin dhe kompaktësimin e nevojshëm të materialit asfaltik; Eliminimi i boshllëqeve ndërmjet kokrrizave të materialit asfaltik, duke rritur qëndrueshmërinë dhe rezistencën e shtresës së përfunduar; Përmirësimi i lidhjes ndërmjet shtresave të asfaltit dhe bazamentit, duke garantuar jetëgjatësi më të madhe të sipërfaqes rrugore; Realizimi i ngjeshjes uniforme në segmentet e rikonstruara, veçanërisht në zonat ku janë kryer hapje kanalesh për vendosjen e linjave të ujësjellësit.

Nevoja për 1 (një) rrull me vibrim për asfalt përdoret në fazat e asfaltimit dhe përfundimit të punimeve rrugore, sipas grafikut të zbatimit. Një njësi është e mjaftueshme për mbulimin e nevojave të kantierit, duke u organizuar sipas segmenteve të asfaltimit dhe progresit të punimeve.

Dumper – 1 copë

Shërben për transportin e materialeve në zona me akses të kufizuar dhe brenda vetë kantierit.

Kërkesa për disponimin e 1 (një) dumperi është e nevojshme në funksion të natyrës së punimeve, volumeve të gërmimeve dhe nevojës për transport të brendshëm të materialeve brenda kantierit gjatë realizimit të punimeve të parashikuara në preventiv.

Dumperi është një mjet i specializuar për transportin e materialeve në distanca të shkurtra dhe në terrene të vështira, duke siguruar fleksibilitet dhe eficiencë në proceset e punës. Ky mjet nevojitet për kryerjen e proceseve si: Transportin e materialeve të gërmuara (dhera, materiale të papërshtatshme, mbetje ndërtimore) nga zonat e hapjes së kanaleve drejt pikave të depozitimit; Furnizimin e frontit të punës me materiale ndërtimore, si rërë, zhavorr, materiale granulare për shtresat mbështetëse të tubacioneve dhe mbushjet teknike; Lëvizjen e materialeve në brendësi të kantierit, veçanërisht në zona ku përdorimi i kamionëve standardë është i kufizuar për shkak të hapësirës së manovrimit ose kushteve të terrenit; Mbështetjen e punimeve të gërmimit dhe sistemit të terrenit, duke garantuar largimin e vazhdueshëm të materialeve dhe moskrijimin e pengesave në zonat e punës.

Disponimi i 1 (një) dumperi do të përdoret si pajisje mbështetëse për makineritë kryesore të punimeve (eskavatorë, fadroma dhe minieskavatorë), duke siguruar vazhdimësinë e procesit të ngarkim–transport–shkarkimit të materialeve. Ky organizim shmang ndërprerjet e punës së mjeteve kryesore për shkak të mungesës së kapacitetit transportues në kantier.

Dumperi paraqet avantazhe të rëndësishme teknike, si: manovrim të lartë në terrene të vështira dhe hapësira të kufizuara; akses në zona ku kamionët me përmasa të mëdha nuk mund të operojnë me eficiencë; rritje të produktivitetit të punimeve të gërmimit dhe mbushjes; përshtatshmëri për punime infrastrukturore të shtrira në segmente të ndryshme të kantierit.

Duke marrë në konsideratë volumet e punimeve të gërmimit, transportit dhe sistemimit të materialeve sipas preventivit, shtrirjen e zonave të ndërhyrjes dhe nevojën për organizim efikas të kantierit, disponimi i 1 (një) dumperi është një kërkesë teknike e arsyeshme dhe proporcionale, e nevojshme për realizimin me ritëm, cilësi dhe siguri të punimeve të kontratës.

Grejder – 1 copë

Nevojitet për profilimin dhe nivelimin e shtresave rrugore dhe sipërfaqeve para asfaltimit ose pas mbushjeve.

Kërkesa për disponimin e 1 (një) grejderi është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të punimeve të parashikuara në preventiv, veçanërisht për realizimin e punimeve të sistemimit, nivelimit dhe përgatitjes së sipërfaqeve pas ndërhyrjeve infrastrukturore.

Grejderi është një makineri e domosdoshme për realizimin e proceseve të punës që kërkojnë saktësi të lartë në profilim dhe nivelim të terrenit, si: Sistemimin dhe nivelimin e traseve pas punimeve të gërmimit dhe mbushjes së kanaleve, duke siguruar kthimin e sipërfaqeve në kuotat dhe pjerrësitë e përcaktuara në projekt; Përgatitjen e bazamentit të rrugëve dhe ambienteve të prekura nga punimet, përpara realizimit të shtresave rrugore dhe rikonstruksionit të sipërfaqeve; Shpërndarjen dhe profilimin uniform të materialeve granulare (zhavorr, stabilizant dhe materiale të tjera të shtresave rrugore); Krijimin e pjerrësive dhe profileve të nevojshme të rrugëve dhe sipërfaqeve të punës, në përputhje me kërkesat teknike të projektit; Punime për mirëmbajtjen dhe sistemimin e rrugëve të aksesit në kantier, të cilat janë të nevojshme për qarkullimin e mjeteve dhe makinerive gjatë zbatimit.

Nevoja për 1 (një) grejder lidhet me faktin se ky mjet përdoret kryesisht në fazat e përgatitjes dhe rehabilitimit të sipërfaqeve dhe nuk kërkohet përdorim i vazhdueshëm në të gjitha proceset e punimeve. Një njësi është e mjaftueshme për të mbuluar nevojat e kantierit, duke u angazhuar sipas grafikut të punimeve në fazat ku kërkohet nivelim dhe profilim me precizion.

Përdorimi i grejderit siguron: cilësi më të lartë të punimeve të sistemimit dhe shtresave rrugore; uniformitet të kuotave dhe pjerrësive sipas projektit; rritje të produktivitetit dhe ulje të kohës së realizimit të punimeve; përshtatje me kërkesat teknike për rikthimin e gjendjes së sipërfaqeve të prekura nga punimet e rrjetit të ujësjellësit dhe veprave shoqëruese.

Duke marrë në konsideratë punimet e gërmimit, mbushjes, rikonstruksionit të segmenteve rrugore, sistemimit të terrenit dhe volumet e përcaktuara në preventiv, disponimi i 1 (një) grejderi përbën një kërkesë teknike të arsyeshme dhe proporcionale, e cila garanton realizimin e punimeve sipas standardeve të kërkuara, brenda afatit kontraktual dhe me cilësinë e përcaktuar në dokumentacionin teknik të projektit.

Autobetoniere – 2 (dy) copë

Kërkesa për disponimin e 2 (dy) autobetoniereve është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës, volumeve dhe shtrirjes së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë realizimin e punimeve me beton për struktura mbështetëse, vepra shoqëruese, puseta, bazamenteve dhe elementëve të ndryshëm konstruktivë gjatë zbatimit të projektit.

Autobetoniere janë mjete të domosdoshme për sigurimin e furnizimit dhe transportit të betonit të gatshëm nga impianti i prodhimit deri në frontet e punës, duke garantuar ruajtjen e cilësisë së betonit dhe respektimin e kërkesave teknike të zbatimit.

Autobetoniere nevojiten për realizimin e proceseve si: Transportin e betonit të gatshëm drejt kantierit, për punimet e betonimit të parashikuara në projekt; Furnizimin e vazhdueshëm të fronteve të punës me beton, për realizimin e puseta, dhomave teknike, bazamenteve, ankorimeve dhe elementëve të tjerë prej betoni; Mbështetjen e punimeve të betonimit në disa zona të ndryshme

të kantierit, duke garantuar vazhdimësinë e procesit pa ndërprerje; Ruajtjen e homogjenitetit dhe punueshmërisë së betonit gjatë transportit, nëpërmjet përzierjes së vazhdueshme gjatë lëvizjes.

Nevoja për 2 (dy) autobetoniere lidhet me organizimin e punimeve dhe mundësinë e zhvillimit të disa proceseve paralelisht. Një autobetoniere mund të jetë e angazhuar në furnizimin e një fronti aktiv betonimi, ndërsa tjetra siguron vazhdimësinë e furnizimit ose mbështet një zonë tjetër pune. Ky organizim shmang ndërprerjet e betonimeve dhe garanton realizimin e punimeve sipas teknologjisë së përcaktuar.

Disponimi i këtyre mjeteve siguron: vazhdimësi të procesit të betonimit dhe shmangie të vonesave teknologjike; kontroll më të mirë të cilësisë së betonit të përdorur në vepër; rritje të produktivitetit dhe eficiencës së punimeve; respektim të afateve të grafikut të zbatimit dhe fazave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë punimet e ndërtimit të veprave shoqëruese të rrjetit të ujësjellësit, realizimin e strukturave prej betoni, volumeve të betonimeve të përcaktuara në preventiv dhe nevojën për furnizim të pandërprerë të kantierit me beton, disponimi i 2 (dy) autobetoniereve është një kërkesë teknike e arsyeshme dhe proporcionale, e nevojshme për garantimin e realizimit të punimeve me cilësi, siguri dhe brenda afatit kontraktual.

Autopompë betoni – 1 (një) copë

Kërkesa për disponimin e 1 (një) autopompe betoni është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë realizimin e punimeve të betonimit për struktura dhe vepra shoqëruese të rrjetit të ujësjellësit, ku kërkohet transportimi dhe vendosja e betonit në mënyrë të kontrolluar edhe në zona me akses të kufizuar.

Autopompa e betonit është një pajisje e specializuar që mundëson transportimin dhe shpërndarjen e betonit nga autobetoniere deri në pikën e betonimit, duke siguruar realizimin e punimeve me shpejtësi, saktësi dhe cilësi të lartë.

Autopompa nevojitet për realizimin e proceseve si: Betonimin e pusetave, dhomave teknike, bazamenteve dhe strukturave të tjera shoqëruese, ku pozicionimi direkt i autobetoniereve mund të jetë i pamundur; Vendosjen e betonit në ambiente me akses të vështirë, ku kërkohet përdorimi i një sistemi pompimi për të arritur zonat e punës; Realizimin e betonimeve në mënyrë të vazhdueshme dhe uniforme, duke shmangur ndërprerjet që mund të ndikojnë në cilësinë e elementëve të betonuar; Reduktimin e punimeve manuale gjatë shpërndarjes së betonit, duke rritur sigurinë dhe produktivitetin në kantier.

Nevoja për 1 (një) autopompë betoni është e justifikuar pasi kjo pajisje përdoret në fazat specifike të betonimeve dhe mbulon nevojat e kantierit nëpërmjet organizimit sipas grafikut të punimeve. Një njësi është proporcionale me kërkesat e projektit, duke qenë se proceset e betonimit zhvillohen në faza dhe jo në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Përdorimi i autopompës së betonit siguron: vendosje më të shpejtë dhe uniforme të betonit në vepër; rritje të cilësisë së punimeve të betonimit; ulje të kohës së realizimit të strukturave prej betoni; mundësi për realizimin e punimeve në zona ku përdorimi i mjeteve të zakonshme të transportit të betonit është i kufizuar;

Makineri (spërkatës) për vijezim rruge me bojë bikomponente – 1 (një) copë

Kërkesa për disponimin e 1 (një) makinerie spërkatëse për vijezim rruge me bojë bikomponente është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë punime rrugore, rikthimin e sinjalistikës horizontale dhe garantimin e kushteve të sigurisë së qarkullimit pas përfundimit të ndërhyrjeve në infrastrukturën rrugore.

Makineria spërkatëse për vijezim me bojë bikomponente është pajisje e specializuar që mundëson realizimin e shenjimeve horizontale me rezistencë të lartë ndaj konsumit, kushteve atmosferike dhe ngarkesave të trafikut, duke garantuar cilësinë dhe jetëgjatësinë e vijëzimeve rrugore.

Kjo pajisje nevojitet për realizimin e proceseve si: Rivendosjen e vijëzimeve horizontale në rrugët e prekura nga punimet, pas përfundimit të punimeve të gërmimit, mbushjes dhe asfaltimit; Realizimin e vijave të trafikut, kalimeve të këmbësorëve, shenjimeve orientuese dhe elementëve të tjerë të sinjalistikës horizontale, sipas kërkesave të projektit dhe standardeve teknike; Aplikimin uniform të bojës bikomponente, duke siguruar trashësinë, gjerësinë dhe cilësinë e kërkuar të shtresës së vijëzimit; Punime në segmente të ndryshme rrugore dhe zona të rehabilituara, ku është e nevojshme rikthimi i plotë i funksionalitetit dhe sigurisë së rrugës.

Nevoja për 1 (një) makineri spërkatëse për vijezim rruge është e justifikuar pasi kjo pajisje përdoret në fazat përfundimtare të punimeve rrugore, pas përfundimit të asfaltimit dhe kur sipërfaqet janë të gatshme për aplikimin e sinjalistikës horizontale. Një njësi është e mjaftueshme për mbulimin e nevojave të kontratës, duke u organizuar sipas grafikut të punimeve dhe segmenteve të përfunduara.

Përdorimi i kësaj makinerie siguron: saktësi dhe uniformitet të vijëzimeve rrugore; rritje të cilësisë dhe jetëgjatësisë së sinjalistikës horizontale; reduktim të kohës së realizimit të punimeve të përfundimit; respektim të kërkesave teknike për sigurinë rrugore dhe standardet e zbatimit; garantimin e kushteve të sigurt për përdoruesit e rrugës pas rikonstruksionit të segmenteve të prekura.

Aparaturë për testimin e ngjeshmërisë së materialit me metodë me goditje – 1 (një) copë

Kërkesa për disponimin e 1 (një) aparature për testimin e ngjeshmërisë së materialit me metodë me goditje është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë punime gërmimi, mbushjeje, rikonstruksion të shtresave rrugore dhe realizim të shtresave mbajtëse pas instalimit të tubacioneve të rrjetit të ujësjellësit.

Aparatura për testimin e ngjeshmërisë shërben për kontrollin e cilësisë së materialeve të ngjeshura në terren, duke verifikuar nëse shtresat e realizuara përmbushin kërkesat teknike të projektit dhe specifikimet e zbatimit.

Kjo aparaturë është e domosdoshme për realizimin e kontrolleve si: Verifikimi i shkallës së ngjeshjes së materialeve të mbushjes së kanaleve pas vendosjes së tubacioneve, duke garantuar stabilitetin e zonës së ndërhyrjes; Kontrolli i shtresave granulare të rrugëve dhe shesheve të rikonstruktura, përpara realizimit të shtresave asfaltike; Vlerësimi i cilësisë së punimeve të ngjeshjes, në mënyrë që të shmangen uljet, deformimet dhe dëmtimet e mëvonshme të sipërfaqeve; Kontrolli i përputhshmërisë së punimeve me kërkesat teknike të projektit dhe standardet përkatëse të ndërtimit.

Nevoja për 1 (një) aparaturë është e justifikuar pasi kjo pajisje përdoret për proceset e kontrollit të cilësisë gjatë fazave të mbushjes, ngjeshjes dhe përgatitjes së shtresave. Një njësi është e mjaftueshme për mbulimin e të gjitha fronteve të punës, duke u përdorur sipas planit të kontrollit të cilësisë dhe progresit të punimeve.

Disponimi i kësaj aparature siguron: kontroll të menjëhershëm të cilësisë së punimeve në kantier; identifikim dhe korrigjim në kohë të zonave me ngjeshje jo të mjaftueshme; garantimin e qëndrueshmërisë së mbushjeve dhe shtresave rrugore; reduktimin e rrezikut të dëmtimeve të mëvonshme të rrugëve dhe infrastrukturës së rikonstruktuar; dokumentimin e rezultateve të kontrollit të cilësisë gjatë zbatimit të kontratës.

Vibrator Betoni – 3 (tre) copë

Kërkesa për disponimin e 3 (tre) vibratorëve betoni është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë realizimin e elementëve dhe strukturave prej betoni si puseta, dhoma teknike, bazamente, ankorime, struktura mbështetëse dhe vepra të tjera shoqëruese të rrjetit të ujësjellësit.

Vibratorët e betonit janë pajisje të domosdoshme për garantimin e kompaktimit dhe homogjenizimit të masës së betonit pas hedhjes në vepër, duke eliminuar boshllëqet e ajrit dhe duke siguruar arritjen e karakteristikave të kërkuara mekanike të betonit.

Këto pajisje nevojiten për realizimin e proceseve si: Ngjeshjen e betonit të freskët gjatë betonimeve, duke siguruar shpërndarje uniforme të masës dhe mbushjen e plotë të kallëpeve; Eliminimin e poroziteteve dhe boshllëqeve të ajrit në beton, duke rritur rezistencën dhe qëndrueshmërinë e strukturave të realizuara; Betonimin e elementëve me përforcime hekuri (armaturë), ku kërkohet depërtim i mirë i betonit ndërmjet shufrave të hekurit; Përfundimin cilësor të sipërfaqeve të betonit, duke shmangur defektet si zgavrat, segregimi dhe dobësimi i shtresave të betonit.

Nevoja për 3 (tre) copë vibratorë betoni lidhet me organizimin e punimeve dhe mundësinë e zhvillimit të disa proceseve të betonimit në mënyrë paralele ose në pika të ndryshme të kantierit. Duke qenë se punimet shtrihen në segmente të ndryshme dhe përfshijnë disa struktura shoqëruese, disponimi i disa vibratorëve garanton vazhdimësinë e punimeve dhe shmang ndërprerjet gjatë fazave të betonimit.

Disponimi i këtyre pajisjeve siguron: rritje të cilësisë së punimeve të betonit dhe përputhje me kërkesat teknike të projektit; realizim më të shpejtë të proceseve të betonimit; mundësi pune në disa fronte njëkohësisht;

Autobot uji – 1 (një) copë

Kërkesa për disponimin e 1 (një) autoboti uji është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë punime rrugore, punime dheu, ngjeshje shtresash, betonime dhe procese të tjera ndërtimore ku kërkohet përdorimi i kontrolluar i ujit gjatë zbatimit.

Autoboti i ujit është një mjet i domosdoshëm për sigurimin e furnizimit dhe shpërndarjes së ujit në kantier, duke mundësuar realizimin e proceseve teknologjike dhe ruajtjen e kushteve të përshtatshme të punës.

Ky mjet nevojitet për realizimin e proceseve si: Lagjen e shtresave të materialeve granulare përpara dhe gjatë procesit të ngjeshjes, duke siguruar arritjen e densitetit të kërkuar të shtresave rrugore dhe mbushjeve; Kontrollin e pluhurit gjatë punimeve të germimit, transportit dhe lëvizjes së mjeteve në kantier, veçanërisht në zona urbane dhe pranë objekteve ekzistuese; Furnizimin me ujë të zonave të punës ku nuk ka akses të drejtpërdrejtë në rrjetin e furnizimit, duke garantuar vazhdimësinë e proceseve ndërtimore; Mbështetjen e punimeve të rikonstruksionit të rrugëve dhe përgatitjes së shtresave para asfaltimit, ku lagështia e kontrolluar e materialeve është element i rëndësishëm për cilësinë e ngjeshjes; Mbështetjen e proceseve të pastrimit dhe mirëmbajtjes së kantierit, sipas kërkesave të organizimit të punimeve dhe mbrojtjes së mjedisit.

Nevoja për 1 (një) autobot uji është e domosdoshme pasi ky mjet përdoret në mënyrë të përshtatur me fazat e punimeve, kryesisht gjatë proceseve të punimeve të dheut, ngjeshjes së shtresave dhe menaxhimit të kushteve të kantierit. Një njësi është e mjaftueshme për mbulimin e nevojave të kantierit, duke u organizuar sipas grafikut të punimeve dhe shpërndarjes së fronteve të punës.

Matrapik – 2 (dy) copë

Kërkesa për disponimin e 2 (dy) matrapikëve është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë punime germimi,

hapje traseje, ndërhyrje në shtresa të forta dhe punime korigjuese gjatë instalimit të tubacioneve dhe rikonstruksionit të sipërfaqeve të prekura.

Matrapiku është një mjet pune i domosdoshëm për realizimin e punimeve manuale dhe ndihmëse, veçanërisht në ato zona ku përdorimi i makinerive të rënda është i kufizuar ose kërkohet ndërhyrje me precizion të lartë.

Matrapikët nevojiten për realizimin e proceseve si: Punime gjurmimi manual në zona të kufizuara, ku makineritë mekanike nuk mund të aksesojnë për shkak të hapësirës së kufizuar ose pranisë së infrastrukturave ekzistuese; Thyerjen dhe lirimin e materialeve të konsoliduara, si dhe i ngjeshur, gurë, shtresa të forta apo materiale të tjera gjatë hapjes së kanaleve; Punime pranë rrjeteve ekzistuese nëntokësore, ku kërkohet kujdes i veçantë për shmangien e dëmtimeve të linjave ekzistuese të ujësjellësit, kanalizimeve, energjisë elektrike apo telekomunikacionit; Rregullime dhe sisteme lokale të shtratit të tubacionit, për përgatitjen e sipërfaqes para vendosjes së tubave dhe realizimit të mbushjeve; Punime ndihmëse gjatë rikthimit të sipërfaqeve të dëmtuara, për përfundimin e punimeve në pika të vështira për akses.

Gjenerator – 2 (dy) copë

Kërkesa për disponimin e 2 (dy) gjeneratorëve është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës, shtrirjes dhe kompleksitetit të punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë punime infrastrukturore në zona të ndryshme dhe procese teknologjike që kërkojnë furnizim të vazhdueshëm me energji elektrike.

Gjeneratorët janë pajisje të domosdoshme për sigurimin e energjisë elektrike në kantier, veçanërisht në zona ku furnizimi i përhershëm nga rrjeti elektrik ekzistues mund të jetë i pamundur, i kufizuar ose i paqëndrueshëm.

Gjeneratorët nevojiten për realizimin e proceseve si: Furnizimin me energji elektrike të pajisjeve dhe mjeteve të punës gjatë zbatimit të punimeve, si vegla elektrike, pajisje saldimi, pompa, ndriçim kantieri dhe pajisje të tjera ndihmëse; Mbështetjen e punimeve në zona të ndryshme të shtrirjes së projektit, ku mund të mos ketë akses të menjëhershëm në furnizim elektrik; Sigurimin e vazhdimësisë së punimeve gjatë ndërhyrjeve në terren, duke shmangur ndërprerjet që mund të shkaktohen nga mungesa e energjisë; Furnizimin me energji të pajisjeve të kontrollit, testimit dhe montimit, të nevojshme gjatë instalimit të tubacioneve dhe elementëve shoqërues të rrjetit; Ndriçimin e zonave të punës në raste kur kërkohet punë jashtë orarit normal ose në ambiente me ndriçim të pamjaftueshëm, duke garantuar sigurinë e punonjësve.

Nevoja për 2 (dy) gjeneratorë lidhet me shtrirjen e kantierit dhe mundësinë e zhvillimit të punimeve në disa fronte njëkohësisht. Një gjenerator mund të përdoret si burim energjie në një zonë aktive pune, ndërsa gjeneratori tjetër siguron mbështetje në një front tjetër ose shërben si rezervë operationale për të garantuar vazhdimësinë e punimeve në rast avarie ose zhvendosjeje të kantierit.

Disponimi i këtyre pajisjeve siguron: vazhdimësi të procesit të punës dhe shmangie të ndërprerjeve teknologjike; rritje të sigurisë dhe eficiencës në kantier;

Tokmak – 2 (dy) copë

Kërkesa për disponimin e 2 (dy) tokmakëve është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë punime gjurmimi, mbushjeje, ngjeshje të shtresave dhe rikthim të sipërfaqeve të prekura nga instalimi i tubacioneve të rrjetit të ujësjellësit.

Tokmaku është një pajisje e domosdoshme për ngjeshjen mekanike të materialeve në zona të kufizuara, ku përdorimi i mjeteve të mëdha të ngjeshjes, si rrulat vibrues, është i pamundur ose joefikas.

Tokmakët nevojiten për realizimin e proceseve si: Ngjeshjen e materialeve mbushëse në kanalet e tubacioneve, veçanërisht në zonat pranë tubit, pushtave, lidhjeve dhe elementëve shoqërues; Ngjeshjen e shtresave në hapësira të ngushta dhe të vështira për akses, ku nuk mund të operojnë makineritë e rënda; Përfundimin e punimeve të rikthimit të sipërfaqeve pas gërmimeve, duke siguruar stabilitetin e shtresave dhe shmangien e uljeve të mëvonshme; Ngjeshjen rreth elementëve të infrastrukturës ekzistuese, ku kërkohet punë e kontrolluar dhe me precizion; Punime ndihmëse në rikonstruksionin e rrugëve, trotuareve dhe ambienteve të tjera të prekura nga punimet.

Nevoja për 2 (dy) tokmakë lidhet me organizimin e punimeve në disa fronte pune dhe me faktin që punimet e mbushjes dhe ngjeshjes së kanaleve zhvillohen në mënyrë të përsëritur përgjatë gjithë gjatësisë së linjave të reja. Disponimi i dy pajisjeve mundëson punën paralele të ekipeve të ndryshme dhe shmang vonesat në proceset e ngjeshjes.

Disponimi i këtyre pajisjeve siguron: arritjen e densitetit të kërkuar të materialeve mbushëse; parandalimin e fundosjeve dhe deformimeve të sipërfaqeve të rikthyera;

Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion” – 1 (një) copë

Kërkesa për disponimin e 1 (një) aparature për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion” është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë instalimin, montimin dhe lidhjen e tubacioneve të ujësjellësit prej polietileni (PE100/PE100 RC), si dhe elementëve përkatës të rrjetit.

Aparatura për bashkimin me metodën “Elektro Fusion” është pajisje e specializuar që mundëson realizimin e lidhjeve të sigurt dhe të qëndrueshme ndërmjet tubacioneve dhe rakorderive PE, nëpërmjet ngrohjes së kontrolluar të elementëve të bashkimit, duke krijuar një lidhje të pandashme dhe rezistente ndaj presionit të punës.

Kjo aparaturë është e domosdoshme për realizimin e proceseve si: Bashkimi i tubacioneve PE100/PE100 RC me rakorderitë përkatëse, sipas kërkesave të projektit dhe specifikimeve teknike; Realizimi i lidhjeve në pika të veçanta të rrjetit, si degëzime, lidhje me elementë kontrolli, kalime dhe ndërhyrje në konfigurimin e linjës; Sigurimi i hermeticitetit të bashkimeve, duke minimizuar rrezikun e rrjedhjeve dhe defekteve gjatë funksionimit të rrjetit të ujësjellësit; Punimet në zona ku kërkohet saktësi e lartë dhe kontroll i parametrave të saldimit, veçanërisht në lidhje me diametra të ndryshëm dhe elementë të veçantë të sistemit.

Nevoja për 1 (një) aparaturë Elektro Fusion është e justifikuar pasi kjo pajisje përdoret në proceset specifike të montimit të tubacioneve dhe lidhjeve të rrjetit. Një njësi është e mjaftueshme për realizimin e punimeve, duke u organizuar sipas grafikut të instalimit dhe fazave të montimit të linjave.

Disponimi i kësaj pajisjeje siguron: cilësi dhe siguri të lartë të bashkimeve të tubacioneve; reduktim të mundësisë së defekteve dhe rrjedhjeve në rrjet; respektim të kërkesave teknike të prodhuesve të tubacioneve dhe rakorderive PE; rritje të jetëgjatësisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit të furnizimit me ujë; kontroll më të mirë të procesit të montimit dhe dokumentim të parametrave të bashkimit.

Aparat për saldimin e tubove – 3 (tre) copë

Kërkesa për disponimin e 3 (tre) aparateve për saldimin e tubove është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë instalimin, montimin dhe bashkimin e tubacioneve të rrjetit të ujësjellësit, veçanërisht tubacioneve prej polietileni (PE100/PE100 RC) dhe elementëve shoqërues të tyre.

Aparatet për saldimin e tubove janë pajisje të specializuara që mundësojnë realizimin e bashkimeve të tubacioneve me metodën e saldimit (butt fusion ose metoda të tjera të përshtatshme

sipas materialit dhe diametrit të tubit), duke garantuar lidhje të qëndrueshme, hermetike dhe rezistente ndaj presionit të punës.

Këto pajisje janë të domosdoshme për realizimin e proceseve si: Saldimin dhe bashkimin e segmenteve të tubacioneve PE, në përputhje me kërkesat teknike të projektit dhe udhëzimet e prodhuesit; Realizimin e montimit të linjave kryesore dhe degëzimeve të rrjetit të ujësjellësit, ku kërkohet numër i konsiderueshëm lidhjesh të salduara; Sigurimin e cilësisë së bashkimeve të tubacioneve, duke garantuar rezistencë mekanike dhe hermeticitet gjatë funksionimit të rrjetit; Përshtatjen e bashkimeve për diametra të ndryshëm tubacionesh, sipas konfigurimit të rrjetit dhe preventivit të punimeve.

Nevoja për 3 (tre) aparate saldimi tubacionesh lidhet me shtrirjen e punimeve dhe organizimin e disa fronteve të punës përgjatë linjave të reja të ujësjellësit. Duke qenë se punimet e shtrimit dhe montimit të tubacioneve mund të zhvillohen paralelisht në segmente të ndryshme, disponimi i disa aparateve siguron vazhdimësi të procesit të saldimit dhe shmang vonesat nga zhvendosja e pajisjes nga një front pune në tjetrin.

Disponimi i këtyre pajisjeve siguron: rritje të produktivitetit dhe ritmit të instalimit të tubacioneve; mundësi për punime paralele në disa segmente të kantierit; garantimin e cilësisë së bashkimeve dhe uljen e rrezikut të rrjedhjeve; respektimin e afateve të përcaktuara në grafikun e punimeve; realizimin e punimeve sipas standardeve teknike të instalimit të tubacioneve nën presion.

Duke marrë në konsideratë gjatësinë dhe shtrirjen e linjave të ujësjellësit, numrin e lidhjeve të nevojshme të tubacioneve, përdorimin e tubave PE100/PE100 RC, nevojën për zhvillimin e punimeve në disa fronte dhe kërkesën për realizimin e bashkimeve me cilësi të lartë, disponimi i 3 (tre) aparateve për saldimin e tubove është një kërkesë teknike proporcionale, e nevojshme për garantimin e realizimit të punimeve me cilësi, siguri dhe brenda afatit kontraktual.

Pajisje për matjen e presionit – 1 (një) copë

Kërkesa për disponimin e 1 (një) pajisjeje për matjen e presionit është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë ndërtimin, instalimin dhe vënien në funksion të rrjetit të ujësjellësit, ku kontrolli i presionit të punës është një element thelbësor për garantimin e funksionimit të sigurt dhe cilësor të sistemit.

Pajisja për matjen e presionit është një instrument i domosdoshëm për verifikimin e parametrave hidraulikë të rrjetit pas instalimit të tubacioneve, si dhe për kontrollin e cilësisë së punimeve të realizuara.

Kjo pajisje nevojitet për realizimin e proceseve si:

Kryerjen e provave hidraulike të tubacioneve nën presion, në përputhje me kërkesat teknike të projektit dhe standardet përkatëse;

Kontrollin e hermeticitetit të bashkimeve të tubacioneve dhe rakorderive, duke identifikuar në kohë rrjedhje ose defekte të mundshme;

Verifikimin e presionit të projektuar të funksionimit të rrjetit të ujësjellësit, përpara vënies së tij në shërbim;

Monitorimin e parametrave të punës gjatë fazës së testimit dhe kolaudimit të sistemit;

Sigurimin e dokumentimit të rezultateve të provave dhe kontrollit të cilësisë së punimeve.

Nevoja për 1 (një) pajisje për matjen e presionit është e justifikuar pasi kjo pajisje përdoret në fazat specifike të testimit dhe kontrollit të rrjetit dhe nuk kërkon përdorim të vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës së zbatimit. Një njësi është e mjaftueshme për mbulimin e nevojave të kontratës, duke u përdorur sipas grafikut të montimit, testimit dhe kolaudimit të segmenteve të rrjetit.

Disponimi i kësaj pajisjeje siguron:garantimin e cilësisë dhe sigurisë së rrjetit të furnizimit me ujë; identifikimin e hershëm të defekteve në tubacione dhe bashkime; parandalimin e problemeve gjatë fazës së funksionimit të veprës; respektimin e kërkesave teknike për testimin e tubacioneve nën presion; sigurimin e dokumentacionit teknik të nevojshëm për pranimin e punimeve.

Kontenier Stacioner – 2 (dy) copë

Kërkesa për disponimin e 2 (dy) kontenierëve stacionerë është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës, shtrirjes dhe kompleksitetit të punimeve të parashikuara në preventiv, si dhe për organizimin efikas të kantierit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Kontenierët stacionerë janë elementë të domosdoshëm për organizimin, administrimin dhe funksionimin normal të kantierit, duke siguruar ambiente të përshtatshme për stafin, dokumentacionin teknik, ruajtjen e pajisjeve dhe materialeve të vogla të punës.

Kontenierët nevojiten për realizimin e funksioneve si:

Krijimi i ambienteve të përkohshme të kantierit, për përdorim si zyrë teknike, ambient administrativ dhe organizim të punës së stafit drejtues e mbikëqyrës; Ruajtja e dokumentacionit teknik të punimeve, përfshirë projektet, ditarët e punimeve, procesverbalet, certifikatat e materialeve dhe dokumentacionin e kontrollit të cilësisë; Magazinimi dhe mbrojtja e pajisjeve të vogla, veglave të punës dhe materialeve ndihmëse, duke shmangur dëmtimin apo humbjen e tyre; Sigurimi i kushteve të përshtatshme për organizimin e punonjësve në kantier, në përputhje me kërkesat për shëndetin dhe sigurinë në punë; Mbështetja e menaxhimit të disa fronteve të punës, duke qenë se punimet e rrjetit të ujësjellësit mund të shtrihen në zona të ndryshme.

Nevoja për 2 (dy) kontenierë stacionerë lidhet me kërkesën për ndarje funksionale të ambienteve të kantierit. Njëri kontenier mund të përdoret për zyrë teknike dhe administrim të punimeve, ndërsa tjetri për magazinim të pajisjeve, materialeve ndihmëse dhe mjeteve të vogla të punës. Kjo ndarje siguron një organizim më të mirë të kantierit dhe ruajtjen e kushteve të punës.

Disponimi i këtyre kontenierëve siguron:organizim të kontrolluar dhe funksional të kantierit; ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit teknik të kontratës; mbrojtjen e pajisjeve dhe materialeve nga faktorët atmosferikë dhe dëmtimet; përmirësimin e kushteve të punës dhe sigurisë për personelin;

Fabrikë Asfalti e pajisur me leje mjedisore – 1 (një) copë

Kërkesa për disponimin e 1 (një) fabrike asfalti të pajisur me leje mjedisore është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë punime rrugore, rikonstrukcion dhe rikthim të shtresave asfaltike të dëmtuara gjatë realizimit të punimeve të instalimit të rrjetit të ujësjellësit dhe veprave shoqëruese.

Fabrika e asfaltit është një element i rëndësishëm për garantimin e furnizimit të vazhdueshëm me material asfaltik cilësor, në përputhje me kërkesat teknike të projektit dhe specifikimet përkatëse të punimeve rrugore.

Kjo pajisje/strukturë nevojitet për realizimin e proceseve si:Prodhimin dhe furnizimin me përzierje asfaltike të nxehtë, të nevojshme për rikthimin e shtresave rrugore pas përfundimit të punimeve të gërmimit dhe vendosjes së tubacioneve; Sigurimin e vazhdimësisë së punimeve të asfaltimit, duke shmangur vonesat që mund të krijohen nga mungesa e furnizimit me material asfaltik; Kontrollin më të mirë të cilësisë së materialit asfaltik, nëpërmjet sigurimit të përbërjes dhe karakteristikave teknike të përshtatshme sipas projektit; Përshtatjen e prodhimit të asfaltit me ritmin e punimeve në kantier, veçanërisht në segmente të ndryshme rrugore të prekura nga ndërhyrjet.

Kërkesa që fabrika e asfaltit të jetë e pajisur me leje mjedisore është e domosdoshme për garantimin e funksionimit të saj në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit,

duke siguruar kontrollin e:emetimeve në ajër; menaxhimit të mbetjeve të procesit të prodhimit; përdorimit të burimeve dhe materialeve; ndikimeve mjedisore gjatë operimit.

Nevoja për 1 (një) fabrikë asfalti shërben si burim furnizimi për të gjitha fazat e asfaltimit të parashikuara në kontratë.

Saldatrice elektrike – 1 (një) copë

Kërkesa për disponimin e 1 (një) saldatrice elektrike është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë punime montimi, instalimi, riparimi dhe ndërhyrje në elementë metalikë dhe struktura ndihmëse gjatë realizimit të veprës.

Saldatorja elektrike është një pajisje e domosdoshme për realizimin e punimeve që kërkojnë bashkim të elementëve metalikë nëpërmjet procesit të saldimit, duke garantuar qëndrueshmëri mekanike dhe cilësi të lidhjeve të realizuara.

Kjo pajisje nevojitet për realizimin e proceseve si:Saldimin e elementëve metalikë dhe pjesëve ndihmëse të përdorura gjatë zbatimit të punimeve, sipas nevojave të kantierit; Punime montimi dhe riparimi të strukturave metalike, mbajtëseve, profileve dhe elementëve të ndryshëm ndihmës; Ndërhyrje të shpejta në kantier për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve apo elementëve metalikë, duke shmangur vonesat që mund të krijohen nga dërgimi i tyre në ambiente të tjera pune; Mbështetjen e punimeve të instalimit të komponentëve të ndryshëm teknikë, ku kërkohen lidhje metalike të sigurta.

Nevoja për 1 (një) saldatrice elektrike përdoret për procese specifike të montimit dhe ndërhyrjeve teknike gjatë zbatimit të kontratës.

Tranxhe hekuri / kthyesë hekuri – 2 (dy) copë

Kërkesa për disponimin e 2 (dy) tranxheve hekuri / kthyesve hekuri është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë punime betoni të armuar, realizim të strukturave shoqëruese, pusetave, dhomave teknike, bazamenteve dhe elementëve të tjerë konstruktivë të nevojshëm për funksionimin e rrjetit të ujësjellësit.

Tranxhet/kthyeset e hekurit janë pajisje të domosdoshme për përpunimin dhe formësimin e armaturave metalike, duke mundësuar prerjen, përkuljen dhe përshtatjen e shufrave të hekurit sipas formave dhe dimensioneve të kërkuara në projekt.

Këto pajisje nevojiten për realizimin e proceseve si:Përkuljen dhe formësimin e hekurave të armimit për elementët prej betoni të armuar, në përputhje me detajet konstruktive të projektit; Përgatitjen e kafazeve të armaturës për pusetat, dhomat teknike, bazamentet dhe strukturat e tjera prej betoni; Realizimin e kthesave dhe elementëve të veçantë të armaturës, të cilat nuk mund të realizohen me saktësi vetëm me mjete manuale; Përshtatjen e hekurave sipas dimensioneve të kërkuara në kantier, duke reduktuar humbjet e materialit dhe duke rritur eficiencën e punimeve.

Nevoja për 2 (dy) copë tranxhe/kthyesë hekuri lidhet me organizimin e punimeve dhe mundësinë e zhvillimit të proceseve të armimit në disa pika të ndryshme të kantierit. Duke qenë se punimet shtrihen në segmente të ndryshme dhe përfshijnë realizimin e disa strukturave shoqëruese, disponimi i dy pajisjeve mundëson punë të vazhdueshme dhe shmang vonesat gjatë përgatitjes së armaturave.

Vinç Eskavator – 1 copë

Përdoret për ngritjen dhe vendosjen e elementeve të rënda gjatë punimeve të montimit dhe ndërtimit.

Kërkesa për disponimin e 1 (një) vinçi eskavator është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë punime të

rrjeteve inxhinierike, instalim tubacionesh, montim elementësh të rëndë dhe ndërhyrje në struktura ekzistuese.

Vinçi eskavator është një mjet multifunksional që kombinon funksionet e gërmimit, ngritjes dhe pozicionimit të materialeve, duke qenë i domosdoshëm për realizimin e proceseve si: Gërmimi i kanaleve dhe punimeve ndihmëse për instalimin e tubacioneve, veçanërisht në zona ku kërkohet një mjet fleksibël që mund të kryejë disa operacione në të njëjtin front pune; Ngritja, zhvendosja dhe vendosja e tubacioneve, rakorderive, elementëve prej betoni dhe materialeve të tjera me peshë, gjatë montimit të rrjetit të ujësjellësit dhe veprave shoqëruese; Pozicionimi i saktë i elementëve të linjës, si puseta, kapakë, pjesë të parapërgatitura dhe pajisje të ndryshme teknike; Punime në zona me akses të kufizuar, ku përdorimi i mjeteve të veçanta të ngritjes ose makinerive më të mëdha do të ishte joefikas; Mbështetja e proceseve të montimit dhe rikonstruksionit, duke siguruar vazhdimësinë e punimeve në kantier.

Disponimi i 1 (një) vinçi eskavator është i mjaftueshëm dhe proporcional me nevojat e projektit, pasi ky mjet përdoret në faza specifike të punimeve ku kërkohet kombinimi i funksionit të gërmimit me atë të ngritjes dhe manipulimit të ngarkesave. Për shkak të karakterit të tij multifunksional, ai mund të mbështesë disa procese pune pa qenë i nevojshëm angazhimi i një numri më të madh mjetesht të këtij lloji.

Ky mjet siguron: rritje të eficiencës në punimet e montimit të tubacioneve dhe elementëve shoqërues; ulje të kohës së realizimit të proceseve të ngritjes dhe pozicionimit; siguri më të lartë gjatë manipulimit të materialeve me peshë; fleksibilitet në organizimin e fronteve të punës.

Duke marrë në konsideratë punimet e ndërtimit dhe rehabilitimit të rrjeteve të ujësjellësit, nevojën për gërmime, montim tubacionesh, vendosje rakorderish dhe elementësh të ndryshëm teknikë sipas projektit dhe preventivit, disponimi i 1 (një) vinçi eskavator është një kërkesë teknike e arsyeshme dhe proporcionale, e cila garanton realizimin e punimeve me siguri, cilësi dhe brenda afatit të përcaktuar kontraktual.

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe personelit

Kërkesa për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të mbrojtjes në punë për punëtorët dhe personelin e angazhuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për Sigurinë në Kantier”, është e nevojshme dhe e argumentuar teknikisht në funksion të natyrës së punimeve, numrit të personelit të angazhuar, shtrirjes së kantierit dhe rreziqeve të mundshme që paraqiten gjatë realizimit të punimeve të ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit dhe veprave shoqëruese.

Punimet objekt kontrate përfshijnë procese me rrezik të shtuar, si gërmime në kanale, punime pranë rrjeteve ekzistuese, përdorim të makinerive të rënda, punime montimi tubacionesh, saldime, betonime, punime rrugore dhe ndërhyrje në zona me qarkullim automjetesh, ndaj është e domosdoshme pajisja e personelit me mjete individuale dhe kolektive të mbrojtjes.

1. Kokore + jelekë fosforeshente – minimumi 70 copë

Kërkesa për disponimin e 70 kokoreve dhe jelekëve fosforeshentë argumentohet nga nevoja për pajisjen e punonjësve të angazhuar në kantier me mjete individuale mbrojtëse dhe identifikuese.

Këto pajisje janë të domosdoshme për: mbrojtjen e kokës nga goditjet aksidentale, rënia e materialeve apo mjeteve gjatë punimeve; rritjen e dukshmërisë së punonjësve, veçanërisht gjatë punimeve pranë rrugëve, në kushte me ndriçim të ulët ose gjatë punës në orare të zgjatura; identifikimin e personelit të autorizuar në zonën e punimeve; reduktimin e rrezikut të aksidenteve në kantier gjatë operimit të makinerive dhe mjeteve të transportit.

Numri 70 copë lidhet me nevojën për pajisjen e fuqisë punëtore të angazhuar në mënyrë të njëkohshme në disa fronte pune.

2. Fikëse zjarri të lëvizshme – minimumi 10 copë

Kërkesa për 10 fikëse zjarri të lëvizshme është e nevojshme për garantimin e masave të mbrojtjes kundër zjarrit në zonat e punës.

Fikëset e zjarrit nevojiten për: parandalimin dhe ndërhyrjen e menjëhershme në rast zjarri nga pajisjet elektrike, gjeneratorët, makineritë, karburantet apo materialet e ndezshme; mbrojtjen e personelit, pajisjeve dhe ambienteve të përkohshme të kantierit; respektimin e kërkesave të sigurisë gjatë punimeve me saldim, prerje metalesh dhe përdorim të pajisjeve mekanike.

Numri 10 copë është i domosdoshëm nevoja për vendosjen e tyre në pika të ndryshme, si zona e magazinimit, kontenerët e kantierit, zonat e punës me makineri dhe frontet aktive të punimeve.

3. Prozhektorë ndriçimi natën – minimumi 4 copë

Kërkesa për 4 prozhektorë ndriçimi për punime natën është e nevojshme për garantimin e sigurisë dhe vazhdimësisë së punimeve në raste kur kërkohet punë në kushte me ndriçim të pamjaftueshëm.

Prozhektorët nevojiten për: ndriçimin e fronteve të punës gjatë orëve të mbrëmjes ose natës; sigurimin e kushteve të sigurt për punonjësit gjatë punimeve në kanale dhe zona të hapura; rritjen e dukshmërisë për operatorët e makinerive dhe personelin ndihmës; parandalimin e aksidenteve për shkak të mungesës së ndriçimit.

4. Komplet i ndihmës së shpejtë – minimumi 7 copë

Kërkesa për 7 komplete të ndihmës së shpejtë është e nevojshme për garantimin e reagimit të menjëhershëm në rast incidentesh apo dëmtimesh të lehta gjatë punimeve.

Këto komplete nevojiten për: dhënien e ndihmës së parë në rast prerjesh, dëmtimesh, djegiesh ose traumash të lehta; vendosjen e pikave të ndihmës së shpejtë pranë fronteve të ndryshme të punës; sigurimin e mbrojtjes së menjëhershme të punonjësve deri në marrjen e ndihmës mjekësore, nëse është e nevojshme.

5. Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – minimumi 10 copë

Kërkesa për 10 tabela paralajmëruese të sigurisë në objekt është e nevojshme për menaxhimin e sigurisë në zonat ku zhvillohen punime dhe ku ekzistojnë rreziqe për punonjësit dhe përdoruesit e rrugës.

Tabelat paralajmëruese nevojiten për: sinjalizimin e zonave të punimeve dhe kufizimin e aksesit të personave të paautorizuar; paralajmërimin për rrezikun nga gërmimet, makineritë në lëvizje dhe punimet rrugore; orientimin e trafikut dhe këmbësorëve pranë zonave të ndërhyrjes; garantimin e respektimit të masave të sigurisë në kantier.

2.3.6. Afati i kryerjes së punimeve

Afati i kryerjes së punimeve është 30 (tridhjetë) muaj sipas Grafikut të Punimeve të publikuar në SPE

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

2.3.7 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me menyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues).

Në funksion të plotësimit të Shtojcës Nr. 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin / Administratorët e shoqërisë, Ortakun / Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posacëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet: *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin;*

Si dhe sipas Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Pika 5 ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

- a) *dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;*
- b) *dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.*

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Bazuar në specifikimet teknike dërguar nga shoqëria projektuese dhe përcjelle për punimet e vepres, duke qenë se specifikimet teknike të përcjella, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 40 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Njesia e Prokurimit